



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM**  
**KANCELARIJA GENERALNOG REVIZORA**  
**OFFICE OF THE AUDITOR GENERAL**

# **RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS**

**2012**

**Prishtinë, Prill 2013**







# ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

## FJALA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

I nderuar z. Kryetar, të nderuar anëtarë të Kuvendit të Republikës së Kosovës



Ky është Raporti Vjetor i Performancës i pesti, të cilin ua kam dorëzuar.

Ky raport përqendrohet në mënyrën se si unë i kam shfrytëzuar burimet që më janë besuar. Përveç kësaj, ai përmbledh rezultatet që zyra ime ka arritur gjatë vitit 2012. Gjithashtu, raporti mundëson krahasimin me dy vitet e mëparshme buxhetore dhe tregon hapat që do të ndërmerren për të adresuar sfidat e hasura.

Raporti Vjetor i Performancës ofron një bazë që më bën mua llogaridhënës për ushtrimin e mandatit tim për vitin 2012. Në të njëjtën kohë raporti duhet të shërbejë si një kontribut në dialogun për buxhetin e vitit 2014.

Gjatë vitit buxhetor 2012 ne finalizuam sezonin e auditimit 2011/12 në gusht dhe filluam sezonin e auditimit 2012/13 në shtator. Rezultatet e rritura nxjerrin në pah se i kemi përdorur mirë parakushtet që Kuvendi na i ka dhënë në formën e burimeve financiare dukshëm më të larta dhe një kufiri më të lartë të stafit krahasuar me vitet e mëparshme. Cilësia dhe mbulimi i auditimit ashtu si dhe ndikimi i punës tonë po përmirësohen në mënyrë të vazhdueshme.

Kjo është si rrjedhojë e përpjekjeve të vazhdueshme për pavarësi; faktit se ne në të gjitha aspektet kryesore i kryejmë detyrat tona në mënyrë të pavarur; se pjesa më e madhe e stafit i dedikohet zhvillimit të

vazhdueshëm dhe ndryshimit si një përgjigje ndaj nevojave, kërkesave dhe pritshmërive të reja; dhe se partnerët dhe kolegët tanë nga vende të ndryshme kanë punuar vërtetë shumë në kuadër të të kuptuarit gjithnjë e më shumë të veçorive dhe nevojave specifike të Kosovës.

Bashkëpunimi jonë konstruktiv me Kuvendin dhe bashkëpunimi vazhdimisht në rritje me ekzekutivin në fushën e Menaxhimit të Financave Publike janë po aq të rëndësishme. Dialogu i vazhdueshëm me organizatat e audituara i kontribuon gjithashtu këtij procesi inkurajues. E fundit, por jo më pak e rëndësishme, mirënjohja jonë shkon për kontributet nga parterët tanë ndërkombëtarë për mbështetjen e dhënë për zhvillimin tonë.

Pavarësia dhe paanësia janë parakushte për një auditim të jashtëm publik mirë-funksionues. Një kornizë e re ligjore për Auditorin e Përgjithshëm është tashmë duke u zhvilluar. Një nga prioritetet e mija, gjatë kohës që më ka mbetur deri në fund të gushtit 2014, është të garantoj që kjo kornizë të jetë në pajtim me standardet e auditimit në sektorin publik të pranuar ndërkombëtarisht dhe të implementohet siç duhet.


Fokusi jonë i ardhshëm, më këtë raport si bazë të tij, do të nxisë në zyrë një kulturë të orientuar nga rezultatet, në të cilën ne përmbushim objektivat tona operative dhe administrative përmes punëtorëve profesional, etik, të motivuar në të gjitha nivelet, të aftë për të ndryshuar në mënyrë konstante sipas kërkesave dhe pritshmërive të reja.

Kjo reflektohet gjithashtu në marrëveshjet e arritura me partnerët aktual dhe ata të rinj, të cilët do të na ndihmojnë për këtë gjatë viteve të ardhshme.

Strategjia jonë është që të bëhemi një institucion publik i auditimit të jashtëm, i cili i zbaton plotësisht dhe në mënyrë të qëndrueshme standardet e auditimit në sektorin publik të pranuar ndërkombëtarisht dhe praktikën e mirë Evropiane. Bashkëpunimi konstruktiv dhe një dialog i fortë për buxhetin me palët tona kryesore të interesit është një kërkesë për arritjen e këtyre ambicieve.

Shpresoj që ky raport do të kontribuoj për këtë.

Auditori i Përgjithshëm,

  
Prishtinë më 30 Prill 2013

# RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS 2012

## TABELA E PËRMBAJTJES

FJALA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM.....	3
1. PËRMBLEDHJE E PERFORMANCËS.....	6
2. TREGUESIT E REZULTATEVE.....	8
2.1 Mbulimi me auditim.....	8
2.2 Cilësia e raporteve tona.....	12
2.3 Ndikimi.....	13
2.4 Vlerësimet e brendshme dhe të jashtme.....	15
3. BURIMET.....	18
3.1 Burimet nga buxheti i Kosovës .....	18
3.2 Donacioni i pasurisë që nuk përdoret më.....	21
3.3 Burimet njerëzore.....	21
4. BASHKËPUNIMI.....	26
5. FOKUSI I ARDHSHËM.....	28
6. LLOGARIDHËNIA E ZAP.....	30
SHTOJCA 1: Parathënie e shkurtër për ZAP.....	32
SHTOJCA 2: Pasqyrat Vjetore Financiare për vitin 2012.....	35
SHTOJCA 3: Opinioni i Auditorit të Jashtëm.....	41

## SHKURTIMISHT RRETH ZAP

**Misioni jonë** është “të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar të administratës publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në pajtim me standardet e auditimit në sektorin publik të pranuar ndërkombëtarisht dhe praktikat e mira Evropiane. Ne do të krijojmë besueshmëri në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesave të taksapaguesve dhe palëve tjera të interesit përmes rritjes së llogaridhënies publike”

**Vizioni ynë** është që të ndërtojmë Institucionin Suprem të Auditimit (ISA), Zyrën Kosovare Kombëtare të Auditimit, të zotëruar plotësisht nga kosovarët dhe e konsideruar nga partnerët ndërkombëtarë dhe palët vendore të interesit si një ISA që vepron mirë.

**Si veprojme?** me theks të veçantë në Periudhën e Planifikimit Strategjik (5 vite), ne i rrisim shkathtësitë e profesionistëve të angazhuar në një qasje pozitive të orientuar në të mësuarit; përmirësojmë marrëdhëniet e ngushta me palët tona të interesit, partnerët vendor dhe ndërkombëtar; marrim pjesë në komunitetin ndërkombëtar të ISA-ve; dhe ofrojmë siguri në të cilën qytetarët e Kosovës dhe përfaqësuesit e tyre të zgjedhur mund të mbështeten në lidhje me shfrytëzimin ekonomik, efektiv, dhe efikas të burimeve publike.

*Ne jemi të dedikuar* që jo vetëm të ofrojmë informacion cilësor mbi përdorimin e fondeve publike, por edhe të ndihmojmë organet tona të audituara që të përmirësojnë sistemet e tyre të menaxhimit financiar, duke i shtuar kështu vlerë veprimtarive të tyre.

*Ne jemi të dedikuar* që të ndihmojmë në ndërtimin e qeverisjes së mirë në Administratën Publike të Kosovës dhe t'i përgjigjemi pritshmërive.

## 1. PËRMBLEDHJE E PERFORMANCËS

### Auditime në kohë, me cilësi, dhe relevancë

*Sezoni i auditimit 2011/12* përfundoi në fund të gushtit 2012. Në total, ne kemi raportuar 101 auditime të ndryshme. Më hollësisht, ne kemi dorëzuar:

- Raportin e auditimit të Buxhetit të Kosovës (BK);
- Tetëdhjetë e gjashtë (86) raporte të auditimit të rregullsisë në kuadër të BK;
- Një (1) auditim i bazuar në sistem;
- Dy (2) auditime të performancës;
- Tetë (8) auditime menaxheriale; dhe
- Tre (3) auditime të fondeve të donatorëve.

*Sezoni i auditimit 2012/13* ka filluar në shtator 2012 dhe planifikojmë të raportojmë 113 auditime:

- Raportin e Auditimit të BK;
- Tetëdhjetë e tetë (88) raporte të auditimit të rregullsisë në kuadër të BK;
- Dy (2) raporte të auditimit të rregullsisë jashtë BK;
- Dy (2) auditime të rregullsisë të fondeve të donatorëve;
- Një (1) auditim i bazuar në sistem;
- Nëntë (9) auditime të performancës; dhe
- Dhjetë (10) auditime menaxheriale.

### Asistimi në zhvillimin e qeverisjes së mirë dhe MFK

- Ne kemi zhvilluar më tej marrëdhënien me Kuvendin. Përveç Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike (KMFP), i cili e shfrytëzon raportet e ZAP-së si një input për të kërkuar llogari nga zyrtarët e lartë, ne kemi filluar gjithashtu të punojmë me komisione të tjera në mënyra të ndryshme; dhe
- Bazuar në konkluzionet tona të auditimit, ne kemi marrë pjesë në ndryshime të ndryshme me degën e ekzekutivit dhe projektet e ndryshme në fushën e MFP-së duke krijuar një bazë të shëndoshë për qeverisje të mirë, transparencë dhe llogaridhënie.

### Llogaridhënia

- Ne kemi përgatitur Raportet Vjetore të Performancës në kohë dhe i kemi diskutuar ato në Komisionin për Mbikëqyrje të Financave Publike, si bazë për të kërkuar llogari nga Auditori i Përgjithshëm për mënyrën se si ai ka menaxhuar zyrën.



## Qeverisja e përbashkët dhe modernizimi

- Ne kemi filluar të zbatojmë Strategjinë dalëse të Auditorit të Përgjithshëm me synimin për të siguruar qëndrueshmëri dhe pronësi. Kjo do të thotë, ndër të tjera, një shkallë më e lartë e delegimit; duke siguruar që i gjithë stafi jonë të kuptojë më thellë bazën, kontekstin, dhe teknikat e Institucioneve Supreme të Auditimit; kemi filluar azhurnimin e skemave të certifikimit për auditorët e sektorit publik; marrëveshjet afatgjate me partnerët ndërkombëtarë; dhe jemi bërë partnerë në bashkëpunimet ndërkombëtare dhe evropiane mes Institucioneve Supreme të Auditimit; dhe
- Ne vazhdimisht kemi ristrukturuar zyrën tonë për të nxitur profesionalizëm dhe efikasitet si dhe kemi zhvilluar mjete dhe instrumente të reja për të siguruar qasje të orientuar në rezultate, fokus, produktivitet dhe kontroll të mirë të menaxhimit.



*Konferenca e ZAP 2012– puna në grup në ditën e dytë të konferencës (11 Korrik 2012)*

## 2. TREGUESIT E REZULTATIT

Ne vazhdojmë të përdorim treguesit e mëposhtëm të rezultateve për të matur dhe raportuar performancën tonë. Ato lidhen me prioritetet tona strategjike dhe bazohen në Strategjinë tonë për Zhvillim të Përbashkët.

2.1 Mbulimi me auditim – matet në aspektin e raporteve të rregullsisë të kryera në kuadër të BK-së dhe numrit të auditimeve të përfunduara;

2.2 Cilësia e auditimeve dhe raporteve tona – me zhvillimin e vazhdueshëm të Sistemit tonë për Menaxhimin e Cilësisë;

2.3 Ndikimi dhe efekti – me numrin e takimeve dhe dëgjimeve publike të mbajtura nga komisioni parlamentar KMFP bazuar në raportet tona dhe me numrin ose përqindjen e rekomandimeve të adresuara; dhe

2.4 Vlerësimet e jashtme dhe të brendshme – me konkluzionet nga vlerësimet e jashtme dhe të brendshme të kryera gjatë vitit.

### 2.1 MBULIMI ME AUDITIM

Për të mundësuar krahasimin me vitet e mëparshme, ne e matim mbulimin e auditimit përmes madhësisë së Buxhetit të Kosovës të përfshirë në auditimin statutor të rregullsisë, numrin e raporteve të finalizuara, dhe opinionet e dhëna të auditimit.

### PËRQINDJA E BUXHETIT TË KOSOVËS TË MBULUAR ME AUDITIM

Auditimi i rregullsisë i organizatave buxhetore për vitin financiar 2011 filloi në shtator 2011. Në dhjetor të të njëjtit vit, për secilën organizatë u hartuan memo auditimi ndërsa raportet përfundimtare të auditimit u publikuan në qershor 2012. Raporti Vjetor i Auditimit u finalizua në gusht 2012, duke shënuar kështu mbylljen e sezonit të auditimit.

Në shtator 2012, ne filluam sezonin e ri të auditimit duke nisur me auditimet e rregullsisë për vitin e ri financiar 2012. Memot e auditimit iu dorëzuan organizatave të audituara në dhjetor, ndërsa raportet përfundimtare do të dorëzohen në qershor dhe gusht 2013

Gjatë viteve të fundit ne kemi rritur mbulueshmërinë e Buxhetit të Kosovës me auditime të rregullsisë. Në vitin 2012 ne kemi mbuluar 100% të të hyrave dhe 99% të shpenzimeve. Ne audituam të gjitha përveç njëjës organizatë buxhetore të nivelit të parë. Përfundimi është Agjencia Kosovare e Inteligjencës për shkak të kornizës së saj ligjore. Megjithatë, ky funksion në demokracitë perëndimore është pjesë e mandatit të Institucioneve Supreme të Auditimit dhe ushtrohet në pajtim me parimet mbi auditimin e jashtëm vjetor.

Përveç kryerjes së auditimit të rregullsisë në secilën organizatë buxhetore, ne kemi kryer gjithashtu lloje të tjera auditimi dhe kemi mbuluar me auditim organizatat të tjera jashtë sistemit të buxhetit, veçanërisht ndërmarrjet publike (si në vijim).



## NUMRI I RAPORTEVE TË AUDITIMIT

Në fund të sezonit të auditimit 2011/2012 ne publikuam 101 auditime:

- Raportin e auditimit të BK-së;
- Tetëdhjetë e gjashtë (86) raporte të auditimit të rregullsisë në kuadër të BK-së;
- Një (1) auditim i bazuar në sistem: Programi për Investime Publike;
- Dy (2) auditime të performancës: Dhënia e kontratave për furnizim dhe ekonomiciteti dhe efikasiteti në prokurimin e pajisjeve të TI-së;
- Tetë (8) auditime menaxheriale: Raportet e auditimit menaxherial: Efikasiteti në menaxhimin e kompanive të ujërave; Procesi i grumbullimit të të hyrave në KEK; Mbikëqyrja e Projekteve për investime kapitale; Ministria e Infrastrukturës; Përcjellja e rekomandimeve të mëparshme të Trepçës; Sistemet e MFK në RTK; Kompaninë e mbeturinave “Deponimi”; Kompaninë e ujërave “Mitrovica”; dhe Agjencinë e Kadastrave të Kosovës; dhe
- Tre (3) auditime të fondeve të donatorëve: Auditim i rregullsisë për programin “Promovimi i punësimit përmes zhvillimit të biznesit dhe aftësive” (DANIDA); auditimet përfundimtare të projekteve Mbindërtimi i Sheshit Skënderbeu në Pejë (UNHABITAT) dhe Kthimi i qendrueshëm në qytetin e Prizrenit (Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar).

Sezoni i auditimit 2012/13 filloi në shtator 2012 dhe planifikojmë të raportojmë 113 auditime:

- Raportin e Auditimit të BK;
- Tetëdhjetë e tetë (88) auditime të rregullsisë në kuadër të BK
- Dy (2) raporte të auditimit të rregullsisë jashtë BK-së;
- Dy (2) auditime të rregullsisë të fondeve të donatorit Programi “Promovimi i punësimit përmes zhvillimit të biznesit dhe aftësive” (DANIDA);
- Një (1) auditim të bazuar në sistem: Sistemi SIGTAS i përdorur nga Administrata Tatimore;
- Nëntë (9) auditime të performancës: Përdorimi i veturave zyrtare; Bursat për edukimin e lartë, Menaxhimi i mbeturinave spitalore; Kompanitë rajonale të ujërave “Ambienti” Sh. Pejë, “Çabrati” Gjakovë, “Ekoregjioni” Prizren, “Pastrimi” Prishtinë, TrainKos si dhe një raport mbi Menaxhimin e Mbeturinave në Kosovë; dhe
- Dhjetë (10) auditime menaxheriale: Infra Kos; Agjencia Kosovare për Ushqim dhe Veterinari; Agjencia Kosovare për Pylltari; Menaxhimi i licencimit në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë; Menaxhimi i prokurimit të investimeve kapitale në komunat e Mitrovicës dhe Shtimes; Policia e Kosovës; Qendra Klinike Universitare e Kosovës; Mirëmbajta e rrugëve – Ministria e Infrastrukturës; Agjencia Kosovare për produkte mjekësore.

Ashtu si në sezonin e mëparshëm të auditimit, ne kemi vazhduar të rrisim numrin e përgjithshëm të auditimeve të kryera. Numri është rritur si për auditimet statutoreshe ashtu edhe për llojet e auditimeve të tjera jo-statutoreshe. Në të njëjtën kohë, ne kemi reduktuar numrin e auditimeve të komunave të kontraktuara tek firmat private të auditimit falë numrit më të lartë të stafit. Ne do të vazhdojmë me këtë trend në sezonin e ardhshëm pasi planifikojmë të punësojmë staf shtesë. Kufizimet e mëparshme në kapacitete janë duke u zgjidhur gradualisht, por ne do të vazhdojmë të kontraktojmë disa auditime të komunave për qëllime të cilësisë dhe krijimit të pikave të referimit.

# RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS 2012

Tabela 1: Auditimet e kryera

	Sezoni i auditimit 2012/2013	Sezoni i auditimit 2011/2012	Sezoni i auditimit 2010/2011	Sezoni i auditimit 2009/2010
<b>Auditimet e rregullsisë</b>	<b>91</b>	<b>87</b>	<b>77</b>	<b>64</b>
BK	1	1	1	1
Autoritetet shtetërore	24	25	24	23
Komunat	38	37	37	33
(Të kontraktuara)	-11	-18	-23	-29
Institucionet e pavarura	26	24	15	7
Jashtë BK	2	0	4	2
<b>Auditimi jo-statutor</b>	<b>22</b>	<b>15</b>	<b>8</b>	<b>4</b>
Auditime të fondeve të donatorëve	2	3	1	1
Auditimet menaxheriale	9	8	4	2
Auditimet e performancës	10	2	3	1
Auditimet e sistemit	1	1		
<b>Total</b>	<b>113</b>	<b>101</b>	<b>89</b>	<b>70</b>
<b>Verifikime</b>	<b>2</b>	<b>18</b>	<b>34</b>	<b>57</b>

Tabela 1 tregon trendin e secilit lloj të auditimit gjatë gjithë sezoneve të auditimit ndërsa tabela 2 tregon numrin e auditimeve të kontraktuara dhe koston për këto auditime.

Tabela 2: Auditimet e kontraktuara tek firmat private të auditimit

	Sezoni i auditimit 2012/2013	Sezoni i auditimit 2011/2012	Sezoni i auditimit 2010/2011	Sezoni i auditimit 2009/2010
Numri i auditimeve	11	18	23	29
Numri i firmave të auditimit	1	2	3	3
Kosto	60.000 <sup>1</sup>	94,000	141,528	141,528

Ne kemi kontraktuar auditimin përfundimtar të Pasqyrave Vjetore Financiare të 11 Komunave për vitin 2012, krahasuar me 18 sa kanë qenë vitin e kaluar. Kjo tregon si zvogëlimin e numrit të auditimeve të kontraktuara ashtu edhe zvogëlimin e kostove në një shkallë të caktuar duke balancuar kostot për stafin shtesë.

Përveç auditimit vjetor të rregullsisë, ne kemi kryer gjithashtu lloje të tjera të auditimeve, siç është e paraqitur edhe në tabelën e mësipërme.

<sup>1</sup> Gjatë kohës së hartimit të këtij raporti, procesi i prokurimit për kontraktimin e auditimeve të PVF-ve të 11 komunave për vitin 2012 ishte duke vazhduar. Ndonëse, €60,000 është një kosto e përlllogaritur për auditimet finale për vitin 2012, pa fazën e ndërmjetme. Për auditimin e plotë të vitit 2013 kostoja është llogaritur të jetë rreth €90,000.

## ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Përshkrimi i përgjithshëm i tërë gamës së auditimeve të kryera na mundëson të prezantojmë një tablo gjithëpërfshirëse të ekzekutimit të përgjithshëm të buxhetit dhe të cilësisë së sistemeve administrative publike. Në këtë mënyrë, ne ofrojmë informacion të gjerë rreth punëve të shtetit dhe jemi në një pozicion më të mirë për të informuar Kuvendin dhe palët e tjera të interesit rreth besueshmërisë në raportet e Qeverisë dhe efikasitetit, efektivitetit, ligjshmërisë, dhe transparencës së ekzekutimit të buxhetit.

Ne kërkojmë në mënyrë aktive të identifikojmë mundësitë për përmirësimin e sistemeve dhe proceseve të administratës publike për të siguruar cilësi më të mirë dhe kosto më të ulëta, dhe për t'i arritur këto ne rekomandojmë opsione.

### OPINIONET E DHËNA TË AUDITIMIT

Secili auditim i rregullsisë rezulton në një opinion të auditimit mbi Pasqyrat Vjetore Financiare (PVF). Opinioni është konkluzioni jonë mbi atë nëse pasqyrat e audituara financiare prezantojnë aktivitetet dhe rezultatet financiare në një mënyrë të drejtë dhe të vërtetë. Kështu, ne gjithashtu arrijmë në përfundimin nëse PVF-të janë përgatitur apo jo në pajtim me standardet e aplikueshme të kontabilitetit dhe udhëzimet e Qeverisë; janë gjithëpërfshirëse; dhe nëse transaksionet themelore janë kryer në të gjitha aspektet kryesore në pajtim me kornizën e aplikueshme ligjore dhe kriteret e tjerat të caktuara.

Opinionet e auditimit që japim ne bazohen në standardet e SNISA-së për raportim.

Ne japim një opinion të pakualifikuar për pasqyrat financiare të cilat, në të gjitha aspektet materiale, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë. Nëse ka çështje të cilat kërkojnë raportim shtesë për të siguruar që lexuesi i PVF-ve t'i kuptojë si duhet çështjet e rëndësishme në lidhje me llogaritë, por të cilat nuk janë aq shqetësuese sa për të rezultuar në një kualifikim, ne mund të shtojmë një 'Theksim të çështjes'.

Kur PVF-të përmbajnë mangësi domethënëse në aspekt të pajtueshmërisë me kornizën raportuese apo cilësisë dhe saktësisë së informacionit të përfshirë, ne aplikojmë një tjetër lloj opinion, i cili mund të marrë formë të ndryshme, por që në thelb pasqyron një kualifikim të llogarive.

Opinionet e auditimit të dhëna gjatë tre viteve të fundit pasqyron një numër në rritje të opinioneve të pakualifikuar. Tabela 3 nxjerr në pah se llojet e tjera të opinioneve janë zvogëluar në mënyrë të qëndrueshme. Organizatat Buxhetore janë duke i përmirësuar proceset e tyre duke mbështetur hartimin e PVF-ve të tyre në çdo vit. Kjo është deri diku rezultat i këshillave dhe rekomandimeve tona të auditimit.



# RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS 2012

Tabela 3: Llojet e opinionëve të auditimit të dhëna për tre vitet me radhë

Llojet e opinionit të auditimit	PVF për vitin 2011	PVF për vitin 2010	PVF për vitin 2009
Opinion i pakualifikuar	35	15	15
Opinion i pakualifikuar me theksim të çështjes	32	35	13
Opinion i kualifikuar	15	19	4
Opinion i kualifikuar me theksim të çështjes	4		
Opinion i kundërt	0	3	0
Mohim i opinionit	3	9	31
<b>Total:</b>	<b>89<sup>1</sup></b>	<b>81</b>	<b>63</b>

## 2.2 CILËSIA E RAPORTEVE TONA

Një nga objektivat strategjike të ZAP-së është që të prodhojë raporte auditimi të cilësisë së lartë. Një zhvillim i vazhdueshëm i Sistemit tonë për Menaxhimin e Cilësisë (SMC) është një synim kryesor.

Ne kërkojmë të arrijmë një profesionalizëm të nivelit të lartë në auditimet tona për të siguruar se ato janë gjithëpërfshirës, të mirë-dokumentuara, të fokusuara në mënyrë efektive, dhe gjithmonë të përfunduara në kohë.

Për të siguruar cilësi, ne zbatojmë rishikimin e cilësisë të punës së kryer në çdo fazë të auditimit. Këtë e bëjmë duke përdorur stafin tonë më me përvojë dhe profesionalisht të kualifikuar.

Ne kemi hartuar politika dhe procedura për ta përfshirë të kuptuarit e cilësisë si një kërkesë themelore.

SMC-ja përmban tre shtresa të ndryshme: a) Kontrolli i cilësisë, b) Monitorimi i cilësisë dhe c) Sigurimi për cilësi.

*Kontrolli i cilësisë* është kontrolli që kryhet për secilën detyrë auditimi. Kjo përfshinë rishikimin mbikëqyrës të planeve të auditimit, përdorimin e dokumentacionit standard për regjistrimin e auditimeve, rishikimin mbikëqyrës të letrave të punës së auditimit dhe të draft raporteve të auditimit etj.

Secili auditim i kryer në sezonin e auditimit 2011/12 i është nënshtruar procedurave të kontrollit të cilësisë. Mbikëqyrja dhe rishikimet janë kryer në të gjitha nivelet duke filluar që nga Udhëheqësi i ekipit, Drejtori i auditimit, përmes Asistentëve të Auditorit të Përgjithshëm e deri tek Auditori i Përgjithshëm. Përveç kësaj, pjesë e këtij procesi janë edhe rishikimet gjuhësore dhe ligjore.

*Monitorimi i cilësisë* është procesi përmes të cilit Njësia për Cilësinë e Auditimit rishikon secilin auditim në mënyrë të pavarur. Ky është një rishikim i përbashkët që kryhet përpara finalizimit të auditimit dhe gjatë fazave të planifikimit, ekzekutimit, raportimit, dhe përcjelljes për të siguruar se auditimi bëhet sipas praktikave dhe politikave tona.

<sup>1</sup> Në numrin total të 89 opinionëve të auditimit përfshihet opinionin i auditimit për programin e DANIDA-s (një auditim i fondit të donatorit). Raporti i auditimit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit përfshinë dy opinione auditimi: opinionin i auditimit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe opinionin për Fondin e Privatizimit.

## ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Për sezonin e auditimit 2011/12, Njësia për Cilësinë e Auditimit ka monitoruar 19 auditime, nga të cilat 17 ishin të rregullsisë dhe dy auditime menaxheriale. Përveç kësaj, për të njëjtën periudhë katër auditime të tjera të rregullsisë u monitoruan nga partnerët tanë ndërkombëtar.

Për sa i përket fazës së ndërmjetme të sezonit të auditimit 2012/13, gjashtë auditime të tjera iu nënshtruan mentorimit i cili është kryer së bashku me Njësinë e Cilësisë dhe partnerëve të binjakëzimit nga MB.

*Sigurimi i cilësisë* është një rishikim që ndodh më pas, i cili përfshin një vlerësim të pavarur të jashtëm ose të brendshëm të sistemeve dhe praktikave tona për kontrollin dhe monitorimin e cilësisë. Kjo bëhet në mënyrë periodike. Hera e fundit kur ne e kemi kryer një rishikim të tillë brenda organizatës ishte në maj të vitit 2011. Gjatë muajve të ardhshëm ne do të adresojmë përsëri sigurimin e cilësisë.

Sistemi jonë i Menaxhimit të Cilësisë ka ndihmuar në përmirësimin e cilësisë së auditimeve tona, dokumentimit të auditimit, dhe raporteve të hartuara. Raportet tona janë më të lexueshme dhe kuptueshme. Përmirësimet në qasjen e auditimit, implementimi i saj, dhe dhënia e opinioneve të auditimit sigurojnë pajtueshmëri më të mirë me standardet ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik dhe praktikat e mira evropiane. Profesionalizmi i stafit tonë është ngritur edhe më tej.

Progresi i arritur në ditët e sotme, është një zhvillim pozitiv por ne e pranojmë se nevojitet zhvillim i mëtejshëm për të arritur ato standarde që ne dëshirojmë t'i arrijmë. Ne na duhet të bëjmë ende shumë për të mbushur zbrazëtitat. Prioriteti ynë është të sigurojmë cilësinë e auditimeve të rregullsisë dhe në të njëjtën kohë të zhvillojmë auditimet e performancës. Pritshmëritë e jashtme për auditim të performancës janë duke u rritur vazhdimisht, prandaj ne e kemi caktuar si prioritet zhvillimin e kësaj fushe. Bashkëpunimi me ZKA-në e Suedisë është duke vazhduar në mbështetje të kësaj.

### 2.3 NDIKIMI

Ne e matim efektivitetin e aktiviteteve tona të auditimit, raporteve të hartuara, dhe ndikimin e tyre aktual duke u bazuar mbi pikëpamjet e parlamentarëve rreth raporteve tona, numrit të dëgjimeve publike, dhe nivelit të adresimit të rekomandimeve të auditimit.

Bashkëpunimi jonë profesional me Komisionin parlamentar për Mbikëqyrje të Financave Publike (KMFP) është zhvilluar më tutje. Besimi i publikut në profesionalizmin e ZAP-së vazhdon të rritet.

Në vitin 2012, ZAP ka dorëzuar në Kuvend 103 raporte, kjo shifër përfshin Raportin Vjetor të Performancës të Auditorit të Përgjithshëm. Këto raporte i kanë ofruar deputetëve një bazë të fortë për vendimmarrje, monitorim, dhe për të kërkuar llogaridhënie nga menaxherët në sektorin publik. Plani jonë vjetor i punës është diskutuar në kohë me KMFP-në për të siguruar që pritshmëritë dhe shqetësimet tona të përbashkëta janë adresuar si duhet.

Gjatë vitit, KMFP ka mbajtur 31 takime të rregullta dhe një dëgjim publik. Në ato takime, KMFP ka trajtuar 20 raporte individuale të auditimit ku prioritet më i madh i është dhënë procesit të përcjelljes së implementimit të rekomandimeve të auditimit. Të gjeturat dhe rekomandimet më të rëndësishme janë diskutuar me menaxherët më të lartë përgjegjës të organizatave të audituara përkatëse.

## RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS 2012

Përveç kësaj, për 37 komuna u organizuan dy punëtori dhe një dëgjim publik. Në këto ngjarje, u diskutuan sfidat më të rëndësishme administrative të hasura nga qeveria lokale dhe mundësitë për përmirësim të identifikuara në raportet e auditimit të komunave.

Në të gjitha këto ngjarje, përfaqësuesit e ZAP-së kanë kontribuar duke i ofruar deputetëve dhe të tjerëve këshilla dhe ekspertizë profesionale, duke ndihmuar në këtë mënyrë në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies publike.

Auditori i Përgjithshëm prezantoi për herë të parë Raportin Vjetor të Auditimit për vitin 2011 në një seancë plenare të Kuvendit. Një zhvillim tjetër i rëndësishëm është që Raporti Vjetor i Performancës i Auditorit të Përgjithshëm, ka përfshirë për herë të parë Pasqyrat Vjetore Financiare të audituara, që u diskutuan gjithashtu në një seancë plenare të Kuvendit



### **Numri dhe përqindja e rekomandimeve të adresuara**

Në secilin nga auditimet tona individuale, ne analizojmë implementimin e rekomandimeve tona të mëparshme. Në 2012, ne kryem analizë në 77 organizata të audituara duke mbuluar si nivelin e qeverisjes qendrore ashtu edhe asaj lokale. Rezultatet e përmbledhëse mund të shihen në tabelën e mëposhtme:



# ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Tabela 4: Zbatimi i rekomandimeve të auditimit të lëshuara për vitin 2010

Entitetet e audituara	Rekomandimet për 2010	Rekomandimet e adresuara plotësisht		Pjesërisht të adresuara (në proces)		Të pa adresuara	
		Nr	%	Nr	%	Nr	%
Organizatata e nivelit qendror	366	145	40	141	38	80	22
Organizatata e nivelit lokal	224	40	18	67	30	117	52
<b>Total</b>	<b>590</b>	<b>185</b>	<b>31</b>	<b>208</b>	<b>35</b>	<b>197</b>	<b>34</b>

Krahasuar me vitet e mëparshme, implementimi i rekomandimeve nga komunat është përmirësuar pak por ende mbetet shumë për tu bërë. Për sa i përket qeverisjes në nivel qendror, situata me rekomandimet e auditimit është shumë më e mirë. Kemi indikacione që janë ndërmarrë masa më të mira lidhur me rekomandimet e dhëna për vitin 2011. Këtë çështje do te adresojmë më vonë në Raportin Vjetor të Auditimit.

Përveç rekomandimeve të mësipërme të dhëna në raportet tona përfundimtare, ne kemi dhënë gjithashtu këshilla gjatë procesit të auditimit. Një pjesë domethënëse e këshillave të dhëna janë adresuar menjëherë, duke përmirësuar në këtë mënyrë cilësinë e informacionit në PVF.

Megjithatë, përkundër kësaj, numri i rekomandimeve të pa adresuara është shqetësues për ne. Arsytet për këtë ndryshojnë. Në disa raste rekomandimet tona kanë qenë shumë të përgjithësuara dhe/ose jo mjaft specifike. Në shumë raste ne mendojmë se mungon gatishmëria ose aftësia për të adresuar mangësitë si duhet. Mekanizmi i llogaridhënies duhet të forcohet për të mbështetur përmirësimin e menaxhimit financiar. Në vitin aktual ne do të fokusohemi që të sigurojmë rekomandime të qarta dhe konstruktive.

## 2.4 VLERËSIMET E BRENSHME DHE TË JASHTME

Në shumë raste, Deputetët e KMFP kanë shprehur kënaqësinë e tyre për mënyrën në të cilën ata kanë vepruar me Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm dhe për mënyrën si ajo i ka dorëzuar informacionin siç është RVP-ja, RVA-ja dhe raportet individuale të auditimit.

Vlerësimi i drejtë dhe objektiv është jetësor për të promovuar zhvillimin si një mjet për përmirësimin e performancës organizative. Me qëllim që të maksimalizojmë efektivitetin dhe besueshmërinë, ne duhet t'i nënshtrohemi auditimeve vjetore të pavarura të rregullsisë, rishikimeve të jashtme me kolegë, dhe vlerësimeve të tjera kombëtare. Në 2012, ZAP është vlerësuar si nga brenda ashtu edhe nga jashtë.

Me qëllim që të vendosnim prioritetet tona për bashkëpunim me ZKA të MB dhe Gjykatën e Auditimit të Holandës në kuadër të projektit të binjakëzimit, ata vlerësuan fokusin tonë aktual operativ. Projekti do të na ofrojë mbështetje në rritjen e mëtejshme të proceseve tona operative dhe mbështetëse.

Në raportin e saj për Besueshmërinë e Sistemeve Financiare të Shteteve, i publikuar në mars 2012, Banka Botërore (BB) e vlerëson efektivitetin e rritur të ZAP-së dhe e konsideron atë si një nga anët e forta më kryesore të sistemit të MFP të Kosovës. Në të njëjtën kohë, ky raport tregon nevojën për forcimin e pavarësisë së ZAP-së.

## RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS 2012

Ngjashëm me Raportin e Bankës Botërore, në Planin e Veprimit të Qeverisë për negociatat e Marrëveshjes për Stabilizim-Asocim, publikuar në dhjetor 2012, theksohet rëndësia e forcimit të pavarësisë funksionale të ZAP-së, e cila duhet të bëhet përmes miratimit të një ligji të ri.

Raporti i SIGMA-s, i publikuar në mars 2012, tregon se ZAP-ja ka një reputacion të mirë në opinionin publik. Derisa disa nga organet e pavarura mbikëqyrëse kanë kohë dhe mundësi të kufizuara për të diskutuar të gjeturat e tyre në Parlament dhe raportet e tyre vjetore trajtohen nga Parlamenti në mënyrë shumë formale, raporti i SIGMA-s e pranon që ZAP përbën një përjashtim në lidhje me këto.

Në Komunikatën nga Komisioni Evropian rreth Studimit të Fizibilitetit për MSA 2012 shprehen shqetësimet e tij rreth faktit se ZAP-i është pjesë e shërbimit civil. Legjislacioni në zbatim i ligjit për shërbimin civil është shumë urdhëruar dhe e kufizon në praktikë pavarësinë operative të ZAP-së. Ai rekomandon forcimin e rolit të auditimit të jashtëm dhe në mënyrë të veçantë thekson nevojën për përmirësimin e kapaciteteve për kryerjen e auditiveve të performancës.

Auditimi i Pasqyrave tona Vjetore Financiare të vitit 2012 rezultoi me një Opinion të Pakualifikuar, ndërsa rekomandimet u dhanë në një letër drejtuar Menaxhmentit. Auditorët e jashtëm, të caktuar nga Kuvendi, vendosën theksin më shumë mbi pajtueshmërinë në proceset tona administrative. Disa gabime të vogla janë vërejtur. Në të njëjtën kohë, është vërejtur një çështje me interes të përgjithshëm që lidhet me amortizimet siç kërkohen nga Udhëzimi Administrativ dhe mënyrës se si llogariten amortizimet në sistemin e Thesarit. Ne do të adresojmë këto rekomandime në kohë.



*Konferenca e katërt vjetore e ZAP-së në Pejë, verë 2012*

## ZYRA E AUDITORIT TË PËRGGJITHSHËM

Si pjesë e vlerësimit tonë të brendshëm, ne kemi aplikuar vegla të ndryshme të cilat adresojnë masat që ne, si një Institucion Suprem i Auditimit, nevojiten që t'i ndërmarrim me qëllim të veprave në mënyrë efektive në një mjedis sfidues dhe vazhdimisht në ndryshim. Kjo do të thotë se ne duhet të ripërcaktojmë dhe rivlerësojmë mënyrën se si e ekzekutojmë mandatin tonë kushtetues dhe ligjor. Ne duhet të sigurohemi se aktivitetet tona i plotësojnë në mënyrë të qëndrueshme standardet më të larta profesionale që mbeten relevante në ambientin në të cilin ne vepruam. Më tutje, Auditori ynë i brendshëm vlerëson funksionalitetin dhe efektivitetin e sistemeve tona të brendshme dhe na këshillon që t'i azhurnojmë ato.

Më tutje, në punëtoritë e organizuara gjatë konferencës tonë vjetore, proceset tona analizohen dhe vlerësohen nga stafi dhe partnerët tanë. Bazuar në mësimet e mësuara, janë identifikuar veprimet të cilat do të kontribuojnë për tu përballur me sfidat e të ardhmes. Kontributi i partnerëve tanë në konferencë ka një vlerë të jashtëzakonshme



*Konferenca e katërt vjetore e ZAP-së në Pejë, verë 2012*



## 3. BURIMET

Gjatë vitit 2012 financimi jonë erdhi nga disa burime. Burimi kryesor i financimit ishte Buxheti i Kosovës. Honorarët e kufizuar që i fitojmë i transferojmë në MF. Burimet e tjera ishin ndihma financiare nga Bashkimi Evropian dhe nga Zyra Kombëtare e Auditimit Suedez. Përveç kësaj, paga e Auditorit të Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të Kabinetit të tij u paguan përmes një fondi donatori pjesërisht i financuar nga qeveria. Që nga mbyllja e ZNK-së në shtator të vitit 2012 ky fond është menaxhuar nga Zyra e Grupit Ndërkombëtar Menaxhues.

### 3.1 BURIMET NGA BUXHETI I KOSOVËS

Si institucion i pavarur i financuar nga paratë e taksapaguesve, Buxheti i ZAP duhet të shpenzohet me përgjegjësi dhe maturi të madhe. Sipas Ligjit të Buxhetit për vitin 2012, buxheti i aprovuar për ZAP ishte 2,009,879€. Ky buxhet është ndarë në pesë kategori ekonomike: Paga dhe Mëditje, Mallra dhe Shërbime, Shërbime Komunale, Investime Kapitale si dhe Subvencione dhe Transfere.

Gjatë vitit fiskal janë bërë ndryshime si më poshtë:

- Me rishikim të buxhetit, kufiri për numrin e stafit u ngrit nga 130 në 136. Për të financuar këtë shumë, 20,000€ janë transferuar nga Subvencionet dhe Transferet. 16,500€ janë transferuar në Paga dhe Mëditje dhe 3,500€ në Mallra dhe Shërbime duke mbuluar nevojat për pajisjet shtesë;
- Sipas Ligjit të Buxhetit për vitin 2012, ZAP-it i është ndarë shuma prej 50,000€ për blerjen e serverëve të rinj. Gjatë procesit të prokurimit, është identifikuar nevoja për 10,000€ shtesë dhe pas kërkesës, Ministria e Financave ka transferuar këtë shumë nga Mallrat dhe Shërbimet në Investime Kapitale;
- Sipas vendimit të Qeverisë nr. 04/101 të datës 14.11.2012, buxheti i ZAP-it për Subvencione dhe Transfere ka rënë në zero, dhe buxheti ynë ishte zvogëluar për 80,000€; dhe
- Zyra Kombëtare Suedeze e Auditimit, në mënyrë që të bashkë-financojë konferencën vjetore e cila u mbajt më 10 dhe 11 korrik në Pejë, ka dhënë një donacion në vlerë prej 7,315€.

Pas këtyre ndryshimeve, buxheti ynë në fund të vitit ishte 1,937,194€.

# ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Tabela 5: Buxheti i ZAP

(në Euro 000)

Raporti i buxhetit	Buxheti fillestar	Buxheti Final	Buxheti i shpenzuar	%
<b>2012</b>				
Buxheti i përgjithshëm	2,010	1,937	1,822	94.1%
Pagat dhe Mëditjet	1,198	1,215	1,174	96.6%
Mallrat dhe Shërbimet	622	622	561	90.1%
Shërbimet komunale	40	40	32	80.0%
Transferet	100			0.0%
Investimet Kapitale	50	60	55	91.7%
<b>2011</b>				
Buxheti i përgjithshëm	1,810	1,866	1,728	92.6%
Pagat dhe Mëditjet	1,098	1,098	1,036	94.3%
Mallrat dhe Shërbimet	672	648	575	88.7%
Shërbimet komunale	40	38	35	92.1%
Transferet		60	60	100.0%
Investimet Kapitale		22	22	100.0%
<b>2010</b>				
Buxheti i përgjithshëm	1,359	1,571	1,547	98.5%
Pagat dhe Mëditjet	797	816	808	99.0%
Mallrat dhe Shërbimet	539	715	707	98.9%
Shërbimet komunale	23	40	32	80.0%


Në tre vitet e fundit, buxheti ynë është rritur. Buxheti final në vitin 2012 ishte 3.8% më i lartë krahasuar me vitin 2011. Dallimi mes 2011 dhe 2010 ishte 18.78%.

Këto rritje kanë qenë kryesisht të lidhura me kostot më të larta të stafit, shpenzimet për zhvillim profesional nëpërmjet skemës së certifikimit dhe rritjes së numrit të udhëheqësve të ekipit.

Ne kemi ulur kërkesën tonë buxhetore për mallra dhe shërbime nën kufirin e propozuar nga Ministria e Financave në qarkoren e parë buxhetore. Ne gjithashtu kemi pasur një qasje të kujdesshme në përgjithësi dhe kemi shtyrë disa investime për shkak të situatës së buxhetit të pamjaftueshëm. Efekti i kësaj është një nevojë e akumuluar e investimeve në fushën e TIK-ut të cilat do të hapnin rrugën për efikasitet më të lartë në aktivitetet operative si dhe ato mbështetëse

Si një reflektim i asaj më sipër, kostot më të larta janë në kategorinë e Pagave dhe Mëditjeve (64%) ose 4% më shumë se në vitin 2011.


Grafiku 1. Shpenzimet buxhetore në kategori ekonomike



# RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS 2012


Grafiku 2. Shpenzimet buxhetore në kategorinë Mallra e Shërbime

Shpenzimet në kategorinë e Mallrave dhe Shërbimeve



Kostoja më e lartë në kategorinë Mallra dhe Shërbime është kosto e qirasë prej 168,000€ ose 27%. 16% lidhet me material për zyrë, telefona mobil, mobilje për zyrë, TI pajisje, ushqim dhe pije dhe shpenzimet për organizimin e konferencës vjetore. 15% lidhet me angazhimin e kompanive të auditimit të jashtëm për të audituar një numër të caktuar të komunave. Në vitin 2011, këto shpenzime paraqitnin 17% të shpenzimeve në këtë kategori, dhe në vitin 2010 ato ishin 33%.

Grafiku 3. Shpenzimet buxhetore sipas kategorive ndër vite



Grafiku 3 tregon trendin e shpenzimeve brenda pesë kategorive buxhetore në një perspektivë tre vjeçare. Shpenzimet për Paga dhe Mëditje janë rritur, ndërsa shpenzimet për Mallra dhe Shërbime janë vazhdimisht në rënie gjatë viteve. Investimet kapitale u rritën për shkak të nevojës për më shumë licenca të softuerit IDEA që përdoret nga auditorët për analizën e të dhënave.



## 3.2 DONACIONI I PASURISË QË NUK PËRDORET MË

Një numër i pasurive tona të amortizuara në aspektin ekonomik u vlerësuan nga komisioni ynë profesional si jo në përputhshmëri me teknologjinë tonë të re. Këto ishin hequr nga përdorimi i mëtutjeshëm dhe ishin ruajtur në depo e cila ndodhet brenda ambienteve të ZAP.

Ne vendosëm që të dhurojmë këto pasuri disa shkollave të cilat me një investim të vogël mund t'i bëjnë këto pasuri të përdorshme. Si vazhdimësi e praktikës së filluar në vitin 2011, në vitin 2012 ne i kemi dhuruar: Shkollës së Mesme "Gjin Gazulli" (MM Nr 155/2012), Shkollës fillore "Faik Konica" (MM Nr 152/2012), Shkollës fillore "Zenel Hajdini" (MM nr. 153/2012), Shkollës fillore "Mihail Grameno", (MM, nr. 156/2012), Shkolla "Qendra Burimore-Përparimi -Prishtinë (MM nr. 154/2012), si dhe Komunës së Malishevës – Drejtoria e Shëndetit dhe Mirëqenies Sociale (MM nr. 157/2012)

## 3.3 BURIMET NJERËZORE

Ne jemi një institucion i cili është vazhdimisht në rritje dhe në fund të vitit 2012 kemi punësuar në total 142 pjesëtarë të stafit, duke përfshirë zëvendësuesit dhe dy nga stafi ynë që janë jashtë buxhetit

Gjatë vitit 2012 ne kemi rekrutuar (18) punonjës. Prej këtyre tetë ishin të punësuar si zëvendësues duke zëvendësuar stafin në pushim të lindjes. Në këtë shifër është përfshirë edhe rekrutimi i Zëvendës Auditorit të Përgjithshëm, i cili filloi punën në institucionin tonë në shtator të vitit 2012. Gjatë pikut të sezonit ne kemi punësuar edhe katër përkthyes për një kohë të shkurtër për të na ndihmuar në përgatitjen e raporteve në kohë.

Ne besojmë në profesionalizëm. Stafi i cili punon në zyrën tonë duhet të jetë i arsimuar mirë, duke u përpjekur që të arrijnë certifikimin profesional dhe përmirësimin e vazhdueshëm të profesionalizmit të tyre. Ne besojmë në mobilizimin e burimeve tona për të siguruar që të marrim vetë në dorë të ardhmen tonë. Ne besojmë në transparencë si diçka themelore në ndërtimin e një institucioni profesional. Kjo nuk mund të arrihet pa staf kureshtar dhe të përkushtuar i cili përpiqet të mësojë vazhdimisht në një institucion që evoluon për përmbushjen e pritjeve të reja dhe kërkesave nga palët e interesuara kombëtare dhe ndërkombëtare.

Në tabelën e mëposhtme kemi paraqitur disa informata themelore në lidhje me stafin tonë.

Tabela 6: Informata themelore në lidhje me stafin tonë

Vitet	Tavani i stafit	Numri i minoriteteve	Përqindja e femrave	Numri i drejtorëve (femra)	Mosha mesatare	Numri i udhëheqësve të ekipit	Lëvizja e stafit <sup>1</sup>	Përvoja në zyrë më e gjatë se dy vite
2008	85	4	17.5%	1	37.4	N/A <sup>2</sup>	11.8%	56
2009	106	5	24.7%	2	38.5	14	13%	59
2010	116	6	38.6%	3	36.8	22	5.2%	67
2011	130	6	43.7%	5	37.0	26	3.2%	73
2012	136	6	45.8%	5	36.7	29	0.7%	108

<sup>1</sup> Përqindja e punëtorëve të cilët japin dorëheqje gjatë vitit nga numri total i punëtorëve në fund të vitit

<sup>2</sup> Gjatë vitit 2008 nuk ka pasur një sistem dhe auditorët kanë marrë rolin e Udhëheqësit të Ekipit përmes rotacionit.

### Gjatë kësaj periudhe:

- Numri i përgjithshëm i stafit është rritur në mënyrë të qëndrueshme;
- Ne i kemi inkurajuar kandidatët potencial nga komunitete të ndryshme, por rezultatet ende nuk janë aq të mira;
- Ne kemi bërë përpjekje të rëndësishme për krijimin e një balance të mirë gjinore në institucionin tonë. Këtu ne kemi qenë të suksesshëm;
- Ne kemi rritur numrin e femrave në pozitave menaxheriale. Për një balancë më të mirë gjinore në këto nivele nevojiten iniciative të mëtejshme.
- Moshën mesatare tregojnë një gjendje të qëndrueshme pa ndonjë luhatje të madhe;
- Ne kemi rritur numrin e udhëheqësve të ekipeve në mënyrë graduale me qëllimin që të kryejmë më shumë auditime dhe të reduktojmë numrin e auditimeve të kontraktuara dhe si rrjedhim koston për këto auditime;
- Largimi i punëtorëve është zvogëluar nga 12% në më pak se 1%; dhe
- Rritja e vazhdueshme e përvojave në auditim për çdo vit, shoqëruar me rezultate të përmirësuara në certifikim (shihni shifrat në tabelën 9), tregojnë një bazë të mirë për të ardhmen.

Në tërësi, kjo tregon se ne kemi hedhur hapa të mirë drejt arritjes së objektivave tona. Ne gjithashtu bëjmë ndryshime çdo vit në organizatë me qëllim që të përmbushim kërkesat e reja (shiko Shtojcën 1).

Në të njëjtën kohë, këto ndryshime të shpejta në organizatë sigurisht që kanë një ndikim në mënyrën se si duhet të organizohet dhe menaxhohet organizata. Sidomos në një ambient i cili ndryshon vazhdimisht parakushtet për trajtimin e Burimeve Njerëzore në të njëjtën kohë kur duhet të jenë standardet e auditimit në sektorin publik të njohura ndërkombëtarisht dhe praktikatat e mira Evropiane ato që drejtojnë zhvillimin.

Nëse duam të përmbushim kërkesat e reja, stafi ynë duhet të kenë:

- Shkathtësitë;
- Kuriozitetin;
- Zotimin;
- Aftësitë komunikuese;
- Konkureshmërinë; dhe
- Mëshirën.

Disave u duhet më shumë kohë që të përshtaten me këtotribute sesa disa të tjerë, ndryshimet nëtribute marrin kohë dhe duhet të organizohen hap pas hapi duke arritur rezultate. Baza për këtë është krijuar por ende mbetet shumë për tu bërë për të siguruar që të gjithë i kuptojnë plotësisht konceptet e auditimit publik modern veç teknikave të auditimit. Masat në këtë drejtim do të kenë një prioritet të lartë në vitin që vjen.

## ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Tabela më poshtë paraqet numrin e përgjithshëm të stafit në poste në 31 dhjetor gjatë tre viteve të fundit.

*Tabela 7 Kategoritë e stafit (në pozitë në fund të vitit)*

Kategoria	2012		2011		2010	
	Shifra aktuale	Pozitat	Shifra aktuale	Pozitat	Shifra aktuale	Pozitat
Stafi auditues	114		98		86	
Stafi Administrativ	28		28		28	
<b>Totali</b>	<b>142<sup>1</sup></b>	<b>136</b>	<b>126</b>	<b>124</b>	<b>114</b>	<b>116</b>

### PROCESET E REKRUTIMIT

Proceset tona të rekrutimit janë të dizajnuara me kujdes, të drejta për të gjithë dhe janë të bazuara në merita. Aktualisht, kandidatët shprehin interesat e tyre përmes postës elektronike në adresë të veçantë elektronike dedikuar rekrutimit

Gjatë vitit 2012 kemi pasur tetë procese rekrutimi, 1035 kandidatë kanë shprehur interesim në shpalljet tona. Ne kemi ftuar 431 kandidatë për tu testuar, 41.6% e numrit të përgjithshëm të kandidatëve. Nga këto 99 u intervistuan.

Një numër kandidatësh kanë bërë edhe pyetje rreth rregullsisë të proceseve tona, ku shumica e tyre kanë qenë në zyrën tonë dhe kanë verifikuar performancën e tyre. Dy raste u drejtuan në Bordin e Pavarur Mbikëqyrës në Shërbimin Civil të Kosovës. Në të dyja rastet kërkesat u hodhën poshtë në favor të ZAP-it.

Tabela e mëposhtme ofron statistika mbi numrin e rekrutimeve në tre vitet e fundit.

*Tabela 8: Rekrutimet*

Kategoritë/Vitet	Rekrutimi		
	2012	2011	2010
Stafi Auditues	18	10	27
Stafi Administrativ	-	5	8
<b>Totali</b>	<b>18</b>	<b>15</b>	<b>35</b>

Për të përmirësuar efikasitetin e proceseve ekzistuese ne (me asistencën e dhënë nga partnerët tanë të binjakëzimit) po konsiderojmë një sistem të aplikimit të bazuar në internet, ku kandidatët mund të plotësojnë të dhënat e tyre në mënyrë të drejtpërdrejtë. Kjo do të jetë pjesë e Sistemit të Informacionit për Burime Njerëzore e cila është planifikuar të instalohet gjatë viteve 2013/14.

<sup>1</sup> Numri i stafit në fund të vitit është 142. Ky numër është më i lartë se numri i pozitave të aprovuara për vitin 2012, megjithatë kjo rritje është për shkak të rekrutimit të zëvendësuesve të cilët zëvendësojnë stafin në pushim të lindjes. Kjo rritje e posteve është në pajtim me Planin e Veprimit për Partneritet Evropian

# RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS 2012

## TRAJNIMI DHE ZHVILLIMI

Ne kemi trajnuar të gjithë menaxherët tanë në Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë, kemi trajnuar një numër të stafit tonë si trajnerë kështu që ne kemi kapacitete të mjaftueshme për të mbështetur trajnimet tona të brendshme dhe skemën e re të jashtme të certifikimit e cila operon përmes SHKÇAK<sup>1</sup>.

I gjithë stafi ka marrë pjesë në aktivitete të ndryshme të trajnimit të brendshëm. 33 Auditorë kanë ndjekur ligjërata në nivele të ndryshme të programit të SHKÇAK. Kjo ka rezultuar me 14,670 orë të trajnimit me një mesatare prej 97 orë trajnimi për anëtar të stafit. Kualifikimet e arritura nga stafi mund të gjendet në tabelën më poshtë.

Përveç numrit total të orëve të ofruara për trajnime, një kohë e caktuar është investuar gjithashtu nga kolegët tanë ndërkombëtarë në mentorimin e stafit tonë në fusha të ndryshme.

Ne gjithashtu kemi nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Prishtinës, ku studentëve i ofrohen programe pune-praktike për një kohë të caktuar kohore.

Tabela 9: Nivelet/Gradat Profesionale

Kategoria	2012	2011	2010
Auditor i Certifikuar	25	24	23
Kontabilist i Certifikuar	29	27	25
Teknik i Kontabilitetit	28	20	14
Auditorët në trajnim	14	21	21
Auditorët e Performancës <sup>2</sup>	8	4	3
Auditor i Brendshëm	1	1	1
<b>Totali:</b>	<b>105</b>	<b>97</b>	<b>87</b>

Për 56 Auditorë që kanë hyrë në provime të SHKÇAK, shkalla e suksesit ishte 32.3%. 12 auditorë kanë arritur të përfundojnë provimet e ndryshme profesionale dhe përafërsisht 2500 orë pushim u janë dhënë për tu përgatitur për këtë.

Në fund të vitit 2012, gjendja e procesit të certifikimit të auditorëve ishte si vijon:

- 51.9% licencuar si Auditor të Certifikuar dhe Kontabilistë të Certifikuar,
- 26.9% kanë përfunduar nivelin e parë;
- 13.5 % janë duke u përgatitur për nivelin e parë, dhe
- 7.7 % janë auditorë të performancës.

Auditori ynë i brendshëm është licencuar sipas skemës së certifikimit për auditorët e brendshëm në Kosovë dhe është certifikuar nga CIPFA si trajner për këtë lëmi të veçantë.

<sup>1</sup> Shoqata e Kontabilistëve të Certifikuar dhe Auditorëve të Kosovës

<sup>2</sup> Numri i auditorëve të performancës është më i madh se ai që tregohet në tabelën më sipër, kjo për shkak të faktit se disa nga auditorët janë të përfshirë në skemën e certifikimit për auditorë të rregullsisë.



## FUSHAT ME FOKUS PËR BNJ

**Strategjia e Re e BNJ-së:** Prezantimi i një Strategjie të Burimeve Njerëzore pritet të zbatohet në vitin 2013 pas miratimit të ligjit të ri i cili prezanton Zyrën Kombëtare të Auditimit të Kosovës. Kjo do të inkorporojë BNJ, Të Mësuarit dhe Zhvillimin si dhe shpërndarjen e shfrytëzimin e stafit.

**Sistemi informacionit për Burimet Njerëzore:** Ne jemi në proces të ndërtimit të një sistemi i cili do të bashkojë të gjitha aktivitetet që lidhen me menaxhimin e burimeve njerëzore në një bazë të dhënash të përbashkët përmes përdorimit të softuerit për planifikimin e burimeve të ndërmarrjes (PBN).

**Regjistrimi i Kohës:** Sistemi i ri i regjistrimit të kohës, projekt i cili kushton, është në zhvillim e sipër për të mbështetur aktivitetet tona. Ne planifikojmë të kemi këtë sistem në funksion në mes të vitit 2014

**Vlerësimet e Stafit:** Ne jemi në proces të rishikimit të sistemit aktual të vlerësimit të stafit për të forcuar cilësinë e vlerësimeve të ndërmarrja me qëllim të ofrojmë një mbështetje më të mirë për stafin.

**Skema e re certifikimit për auditorë:** Skema e re certifikimit për auditorë të rregullsisë në sektorin publik do të zbatohet gjatë vitit 2013. Ajo do të bazohet në standardet SNISA dhe do të ndahet në faza të ndryshme. Skema formale teknike e certifikimit do të ofrohet nga SHKÇAK.

### 4. BASHKËPUNIMI

Bashkëpunimi efektiv me palët tona të interesit është një parakusht për zhvillim cilësor të rezultateve tona dhe për aktivitetin tonë për të pasur ndikimin e duhur dhe të nevojshëm. Ne jemi të fokusuar në zhvillimin e mëtejshëm të bashkëpunimit tonë me palët e interesit si në nivel vendor ashtu dhe atë ndërkombëtar.

Bashkëpunimi me Kuvendin e Kosovës, veçanërisht kryesori me Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike, është një mekanizëm për përmirësimin e llogaridhënies lidhur me mënyrën se si menaxhohen dhe përdoren paratë publike.

Për më tepër, bashkëpunimi me institucionet e nivelit lokal dhe atij qendror që ne i këshillojmë, mbështesim dhe i auditojmë, është një qasje e integruar. Qasja e përdorur siguron një pamje të zakonshme mbi faktet dhe një perspektivë të fokusuar në mënyrë të vazhdueshme në përmirësimin e qeverisjes së mirë, në dizajnin e sistemit, implementimin e procesit dhe masave korrigjuese. Rekomandime të qarta dhe koncize në raportet tona të auditimit janë elemente kyçe për këtë.

Qasja jonë e drejtuar në të qenit pro-aktiv në forcimin e menaxhimit financiar publik, kërkon një bashkëpunim të mirë-zhvilluar, në veçanti, me Ministrinë e Financave. Nga një perspektivë më e gjerë, ne jemi të fokusuar në mbështetjen e zhvillimeve të promovuara nga BE-ja siç është IPA dhe do të punojmë me BE-në për të siguruar që ne të mund të mbështesim Qeverinë në adresimin e sfidave të qeverisjes që lidhen me këtë.

Një bashkëpunim i forcuar me Autoritetet Hetimore dhe organet e drejtësisë ka rezultuar me qartësimin e roleve dhe shkëmbimin me kohë të informacionit.

Ne i konsiderojmë marrëdhëniet me publikun dhe mediat si pjesë kyçe të politikave dhe strategjive tona. Bashkëpunimi ynë me organizatat jo-qeveritare; shoqërinë civile; shoqatat profesionale, firmat private të auditimit, ofruesit kombëtar të trajnimeve dhe donatorët është vazhdimisht në zhvillim. Ne konsiderojmë që, duke u perceptuar si transparent dhe të drejtë për publikun kur ofrojmë informata, niveli i bashkëpunimit do të rritet edhe më shumë sikurse niveli i të kuptuarit të fokusit, përfitimeve dhe ndikimit të punës sonë.

Ne kemi një fokus të fortë mbi zhvillimin profesional të mbështetur përmes bashkëpunimit me partnerët tanë nga Institucionet Supreme të Auditimit të Suedisë, Anglisë, Holandës, Estonisë dhe Skocisë

Marrëdhëniet bilaterale të bashkëpunimit janë ndërtuar në mënyrë të vazhdueshme. Bashkëpunimi me Institucionin Suprem të Auditimit të Shqipërisë është më i zhvilluari deri më tani.



*Z. Leskaj dhe Lage Olofsson duke nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit*

Ne nuk kemi arritur ende që të jemi anëtar të INTOSAI-t, pasi Kosova ende nuk është anëtare e Kombeve të Bashkuara. Megjithatë, ne jemi në gjendje të marrim pjesë në nivel pune në rrjete të ndryshme, konferenca dhe seminare të karakterit rajonal dhe atij evropian. Në këto takime, ne ndajmë përvojat me kolegët e vendeve të tjera.

### **Projektet**

#### **Bashkëpunimi me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Suedisë**

Së bashku me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Suedisë, ne kemi nënshkruar një Memorandum të Mirëkuptimit. Ne kemi rënë dakord të kemi një projekt bashkëpunimi që do të zgjasë deri në verë të vitit 2016. Ky projekt ka për qëllim zhvillimin e kapaciteteve të ZAP, veçanërisht në auditim të performancës, në mënyrë që të përmbushë mandatin e tij. ZKAS do të kontribuojë edhe në aspekte të tjera që do të kontribuojnë në qëndrueshmëri institucionale. Koha e përfundimit të këtij projekti mundëson një qasje fleksibile rreth përfundimit të projektit të binjakëzimit.

#### **Projekti i Binjakëzimit**

Bashkimi Evropian ka dhënë një grant për projektin e binjakëzimit për të mbështetur më tej zyrën tonë. Zyra Kombëtare e Auditimit të Mbretërisë së Bashkuar është partneri kryesor ndërsa Gjykata e Auditimit të Holandës është Partner Junior. Mbështetje është siguruar edhe nga Zyra e Auditimit të Skocisë dhe ZKA e Estonisë. Objektivi i përgjithshëm është të kontribuojë për administrimin e duhur të fondeve publike, transparencë dhe efektivitet në shpenzime publike nëpërmjet përmirësimit të sistemit të menaxhimit të financave publike, krijimit të një kornize efektive të qeverisjes publike, dhe ndërtimit të besimit në shpenzimet publike duke rritur përgjegjshmërinë publike. Një projekt 30 mujor që do të përfundojë në mars 2015 është duke mbështetur zhvillimin e aktiviteteve operative të zgjeruara në të gjitha format e auditimit si dhe aktivitete mbështetëse kryesore dhe përkrahje për ekipin menaxhues në përgatitje për emërimin e Auditorit të Përgjithshëm të ri.

## 5. FOKUSI I ARDHSHËM

Arritjet aktuale janë të shumta dhe tregojnë se ne me shpejtësi jemi duke krijuar një profil të fortë duke siguruar interesin e parave të taksapaguesve. Më shumë theks nevojitet në të menduarit strategjik në të gjitha nivelet organizative, duke siguruar që objektivat e synuara afatgjata janë të qarta për të gjithë në institucionin tonë.

Një institucion publik i auditimit të jashtëm i cili vepron plotësisht në përputhje me standardet e auditimit në sektorin publik të pranuar ndërkombëtarisht dhe praktikën e mirë evropiane është objektivi ynë strategjik i përhershëm. Pritshmëritë e palëve tona të interesit janë në rritje dhe me siguri do të përcillen me sfida të shumta të cilat do të kërkojnë planifikimin e masave adekuata për t'i tejkaluar ato.

Zbatimi i strategjisë dalëse të Auditorit të Përgjithshëm është një sfidë e veçantë për sigurimin e pavarësisë së ZAP-it, qëndrueshmërisë dhe aftësisë për menaxhimin e ndryshimeve. Mandati i Auditorit të Përgjithshëm do të përfundojë në gjysmën e dytë të vitit 2014.

Me qëllim që të ekzekutojmë mandatin tonë ne planifikojmë, në periudhën afatmesme, të përmbushim objektivat e mëposhtme:

- **Sigurimi i pronësisë vendore dhe qëndrueshmëria institucionale**
- **Kontribuimi në forcimin e qeverisjes së mirë**
- **Zhvillimi dhe ruajtja e cilësisë së organizatës dhe auditimit**

Për sa i përket objektivit të parë **“Sigurimi i pronësisë vendore dhe qëndrueshmëria institucionale”** ne planifikojmë të kryejmë veprimet e mëposhtme:

- Mbështetja për të pasur ligjin për AP dhe ZAP në pajtim me standardet e auditimit në sektorin publik të njohura ndërkombëtarisht;
- Hartimi i udhëzuesve të brendshëm në lidhje me ligjin e ri dhe zbatimin e tyre;
- Ndryshimi i Strategjisë për Zhvillim Korporativ;
- Përgatitja dhe kontribuimi për një zëvendësim të shpejtë dhe të matur të Auditorit të Përgjithshëm në gusht të vitit 2014 pa e humbur momentin e ndërtimit të qeverisjes së mirë;
- Thellimi i mëtejshëm i partneritetit afat gjatë dhe mirë funksionues me partnerët tanë;
- Sigurimi i zbatimit të një kulture e orientuar në rezultate në të cilën ne përmbushim objektivat tona operative dhe administrative përmes punëtorëve profesional, etik, të motivuar në të gjitha nivelet;
- Ofrimi i asistencës për kolegët e Sindikatës për të zhvilluar rolin dhe qasjet e saj në pajtim me praktikën e mira Evropiane;
- Zhvillimi i mëtejshëm i bashkëpunimit rajonal me organizatat simotra dhe një nivel më i lartë i pjesëmarrjes në rrjetet ndërkombëtare ku këmbehen dhe mësohet nga përvojat e fituara; dhe
- Forcimi dhe zhvillimi i vazhdueshëm i kapaciteteve të brendshme organizative për të përmbushur kërkesat për ndryshim dhe menaxhimin e tij.

Me qëllim që të plotësojmë objektivin e dytë **“Kontribuimi në forcimin e qeverisjes së mirë”** ne planifikojmë të kryejmë veprimet e mëposhtme:

- Konsolidimi i cilësisë së Auditimit të Rregullsisë dhe forcimit të Auditimit Menaxherial dhe atij të Performancës;



## ZYRA E AUDITORIT TË PËRGGJITHSHËM

- Zhvillimi i mëtejshëm i rëndësisë së auditimit duke kryer në mënyrë graduale më shumë auditime të performancës;
- Zhvillimi i auditimit tonë të fondeve të donatorëve, bazuar në tarifë, duke hapur rrugën për marrëdhënie të reja financiare në mes të Kosovës dhe komunitetit të donatorëve. Si të tilla ne planifikojmë të kryejmë rreth 3–4 auditime të fondeve të donatorëve;
- Më shumë fokus në fushat me interes për menaxhimin e decentralizuar të fondeve të IPA-s;
- Zhvillimi i mëtejshëm i auditimit të sistemeve të TI-së;
- Adresimi i fushave të reja të auditimit dhe futjen në përdorim të një qasje më të fokusuar në sistemin e prokurimit dhe në mënyrën se si ofrohen shërbimet publike në forma të tjera (PPP, NP, privatizimi);
- Vazhdimi i hartimit me kohë të RVA-së me cilësi të rritur bazuar mbi një relevancë më të madhe të auditimit si dhe të raporteve të lexueshme;
- Futja në përdorim i qasjeve, formave dhe masave të reja që synojnë të zhvillojnë dhe përmirësojnë qeverisjen e mirë;
- Zhvillimi i mbështetjes për funksionin e mbikëqyrjes parlamentare;
- Zhvillimi i bashkëpunimit me Ekzekutivin në fushën e Reformës në Administratën Publike, dhe
- Thellimi i bashkëpunimit dhe komunikimit të jashtëm me shoqërinë civile, mediat dhe projektet.

Me qëllim që të plotësojmë objektivin e tretë **“Zhvillimi dhe ruajtja e cilësisë”** ne planifikojmë të kryejmë veprimet e mëposhtme:

- Forcimi i funksionit të cilësisë;
- Implementimi i skemës së re të certifikimit, e cila është në pajtim me SNISA dhe do të vihet në zbatim në korrik 2013;
- Më shumë efikasitet në auditim përmes zgjidhjeve të reja nga TIK;
- Futja në përdorim e veglave menaxheriale dhe administrative;
- Rritja e numrit të auditorëve të licencuar dhe certifikuar dhe auditorëve të rinj të punësuar gjatë viteve 2014-2016; dhe
- Gjetja e një zgjidhje të realizueshme për kompensim për të ruajtur stafin e lartë profesional i zhvilluar në zyrën tonë.



## 6. LLOGARIDHËNIA E ZAP

### Sigurimi i integritetit

Përmes kësaj, garantoj se informacioni në Raportin Vjetor të Performancës, përfshirë edhe pasqyrat financiare, janë të sakta, të besueshme, dhe objektive.



Lars Lage Olofsson, Auditor i Përgjithshëm

### Deklarata e Transparencës

Përmes kësaj, garantojmë se puna jonë gjatë vitit 2012 është kryer në pajtim me Statutin e Shërbimit Civil dhe Kodin e mirësjelljes së ZAP-it



Artan Venhari, Zëvendës Auditor i Përgjithshëm



Qerkin Morina, Asistent Auditor i Përgjithshëm;



Ibrahim Gjylderren, Asistent Auditor i Përgjithshëm;



Ilire Daija-Buza, Shefe e Kabinetit të AP/Marrëdhënieve me Publik

# SHTOJCAT

## SHTOJCA 1: PARATHËNIE E SHKURTËR PËR ZAP

### ROLI

Auditori i Përgjithshëm është institucion kushtetues i pavarur dhe i raporton drejtpërdrejtë Kuvendit. ZAP ndihmon Auditorin e Përgjithshëm, mandati dhe detyrat e të cilit janë të përcaktuara me Kushtetutë dhe me Ligjin nr. 03/L-075 për themelimin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës dhe Zyrës së Auditimit në Kosovë. Auditori i Përgjithshëm aktual u emërua në fillim të vitit 2009 nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar (PCN). Mandati i tij do të përfundojë në Gusht 2014.

Në ushtrimin dhe përmbushjen e detyrimeve të tij për arritjen e objektivave, Auditori i Përgjithshëm gëzon liri të plotë të ndërmarrë veprimet e duhura në funksion të mandatit të tij. Ai përgjigjet vetëm para Kuvendit.

Ruajtja e objektivitetit dhe pavarësisë tonë nga organizatat të cilat i auditojmë është vendimtare. Objektiviteti dhe pavarësia duhet të sigurohen me anë të zbatimit të mirë të një mandati të gjerë, të qëndrueshëm, dhe ligjor; pajtueshmërisë me standardet e auditimit në sektorin publik të pranuar ndërkombëtarisht, dhe një kodi të brendshëm për mirësjelljes profesionale.

### AKTIVITETI JONË

Ne kryejmë Auditimet e Rregullsisë të Buxhetit të Kosovës dhe të gjitha organizatave buxhetore në bazë vjetore, ku përfshihen Kuvendi, Zyra e Presidentit, çdo ministri dhe agjenci ekzekutive, komunat, organet e pavarura dhe entitete të tjera.

Ne gjithashtu kryejmë Auditime të Performancës. Kjo është në fushëveprimin tonë, por nuk është një kërkesë vjetore e parashikuar me ligj. Këto auditime do të kryhen në mënyrë që të vlerësojmë nëse programet qeveritare janë duke u menaxhuar si duhet, ekonomikisht, dhe në mënyrë efikase, dhe nëse janë vendosur masa për matjen dhe raportimin e efikasitetit të tyre.

Ne raportojmë për auditimet tona tek entitetet e audituara dhe Kuvendi (KMFP) dhe këto raporte do të publikohen. Raportet tona do të përmbajnë rekomandime me qëllimin për të nxitur ndryshim dhe praktika më të mira. Me këtë duam t'i ofrojmë Kuvendit, Qeverisë, dhe Taksapaguesve një shërbim auditimi profesional të bazuar në fakte dhe të integruar.

Me qëllim që të ndihmojmë në zbatimin, zhvillimin dhe qëndrueshmërinë e Menaxhimit të Financave Publike, ne do të sigurojmë tatimpaguesit dhe donatorët ndërkombëtar se burimet publike përdoren në mënyrë ekonomike, efektive dhe efikase. Ne e bëjmë këtë duke siguruar se fondet publike raportohen, administrohen dhe përdoren në mënyrën e duhur dhe me maturi.

### PROCESI I LLOGARIDHËNIES

Pasqyrat tona Vjetore Financiare (PVF) përgatiten sipas Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Ato janë në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik mbi Bazat e Parasë së Gatshme dhe modifikimet e aplikueshme sipas vendimit të Qeverisë. Për



## ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

të na mundësuar të dëshmojmë përgjegjshmërinë dhe objektivitetin tonë, Kuvendi çdo vit duhet të emërojë një auditor të jashtëm për të bërë auditimin e Pasqyrave tona Vjetore Financiare.

Kuvendi cakton auditorët e jashtëm për ne. Opinioni i auditimit mbi PVF-të e vitit 2012 është përfshirë në Raportin Vjetor të Performancës, së bashku me PVF-të. Në letrën e auditorëve të jashtëm drejtuar menaxhmentit janë përfshirë shkurtimisht rekomandimet si dhe komentet tona ndaj tyre. Në këtë mënyrë ne ua mundësojmë lexuesve të kenë një pamje, pas auditimit, rreth mënyrës se si i kemi përdorur burimet që na janë dhënë dhe rezultatet nga kjo. Raportet janë të publikuara në faqen tonë të internetit<sup>1</sup>.

Përpos auditimeve të jashtme, edhe auditimet e brendshme të kryera nga njësia për auditim tëbrendshëm sigurojnë që Zyra vepron në pajtueshmëri me ligjet dhe politikat e veta.

### KUSH DO T'I VLERËSOJË METODOLOGJITË TONA TË AUDITIMIT?

Ne kemi bërë shumë për të siguruar që të ndjekim praktikën dhe metodologjinë e mira të auditimit. Ne jemi duke zbatuar një kornizë të menaxhimit të cilësisë. Metodologjinë e mira dhe korniza e cilësisë sigurojnë që auditimet tona kryhen në pajtim me standardet<sup>2</sup> e themeluara të praktikës profesionale.

Ne ndjekim sistemin e rregullt ndërkombëtar të kontrolleve mbi punën tonë të auditimit; auditimet tona ekzistojnë në kuadër të një kornize rigoroze të standardeve të auditimit, të cilën stafi mëson se si ta përdorë gjatë programit tonë të trajnimit. Pastaj, gjatë një procesi qartësimi, diskutohet me entitetet e audituara për të gjeturat e auditimit. Në sistemin tonë është ndërtuar rishikimi nga ana e menaxhmentit dhe monitorimi i mëtejshëm bëhet nga një funksion i veçantë në kuadër të Zyrës. Pas kësaj, raportet tona publikohen dhe janë të hapura për ekzaminim. Pastaj fillojnë shqyrtimet dhe diskutimet në Kuvend së bashku me Ekzekutivin rreth rekomandimeve të auditimit.

### KUSH DO TË RISHIKOJË FINANCIMIN TONË?


Si Auditor i Përgjithshëm, unë – përveç këtij Raporti Vjetor të Performancës që fokusohet në mënyrën se si është shpenzuar buxheti i Zyrës së Auditimit – do të përgatis dhe dorëzoj çdo vit në Kuvend kërkesat buxhetore. KMFP dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa mund të më drejtohen mua për të shpjeguar kërkesën buxhetore për Zyrën dhe për të diskutuar raportin tonë mbi planet dhe prioritetet, objektivat e performancës, raportin tonë vjetor të performancës, dhe praktikën tonë të menaxhimit.

Qeveria e inkorporon kërkesën time buxhetore në draft Buxhetin e Kosovës të paraqitur në Kuvend ashtu siç është e propozuar nga Komisioni për Buxhet dhe Financa. Buxheti i Zyrës do të aprovohet nga Kuvendi. Praktikisht, proceset aktuale nuk janë të dizajnuara mirë dhe praktikën lejnë vend për përmirësim.

<sup>1</sup> <http://www.oag-rks.org>

<sup>2</sup> ISSAI, International Standards of Supreme Audit Institutions përcaktojnë parakushtet themelore për funksionimin e duhur dhe sjelljen profesionale të institucioneve të tilla: [www.issai.org](http://www.issai.org)

## ORGANIZIMI I ZAP PËR 2012/13



# ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

## SHTOJCA 2: Pasqyrat Vjetore Financiare 2012 dhe Adresimi i Rekomandimeve të dhëna në 2011

### Pasqyra financiare 1.

Pasqyra e pranimeve dhe pagesave të parave të gatshme për Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm për vitin e përfunduar me 31 Dhjetor 2012

1

Shënime shpjeguese	2012			2011			2010		
	Llogaria e Vetme e Thesarit BK			Llogaria e Vetme e Thesarit BK			Llogaria e Vetme e Thesarit BK		
		€ '000		€ '000		€ '000		€ '000	
<b>BURIMET E FONDEVE</b>									
Granti Qeveritar	1	1,815		1,728		1,547			
Grantet e përcaktuara të donatorëve	2	7							
<b>Totali i Pranimeve</b>		<b>1,822</b>		<b>1,728</b>		<b>1,547</b>			
<b>SHFRYTËZIMI I FONDEVE</b>									
Operacionet									
Pagat dhe Mëditjet	3	1,174		1,037		808			
Mallrat dhe Shërbimet	4	561		574		707			
Shërbimet Publike	5	32		35		32			
		<b>1,767</b>		<b>1,646</b>		<b>1,547</b>			
Transferet dhe Subvencionet		-		60					
Shpenzimet Kapitale	6	55		22					
<b>Totali i Pagesave</b>		<b>1,822</b>		<b>1,728</b>		<b>1,547</b>			

### Pasqyra financiare 2.

Pasqyra e realizimit të buxhetit

Pasqyra e krahasimit të shumave buxhetore aktuale për Zyrën e Auditorit të Përgjithshëm për vitin e përfunduar me 31 Dhjetor 2012

2

Shënime shpjeguese	2012				2011	2010	
	Buxheti fillestar (Ndarja) A	Buxheti Final (Ndarja) B	Aktuali C	Variance D=C-B	Realizimi E	Realizimi F	
	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	
Hyrja e parasë së gatshme në llogari të Thesarit							
<b>Pranimet totale të mbledhura për BK-në</b>	-	-	-	-	-	-	
<b>Daljet e parasë së gatshme nga llogaritë e thesarit</b>							
Pagat dhe mëditjet	7	1,198	1,215	1,174	(41)	1,037	808
Mallrat dhe Shërbimet	8	622	622	561	(61)	574	707
Shërbimet publike		40	40	32	(8)	35	32
Transferet dhe Subvencionet	9	100	-	0	-	60	
Shpenzimet kapitale	10	50	60	55	(5)	22	
<b>Totali i pagesave i bërë nga BK përmes LIVTh</b>		<b>2,010</b>	<b>1,937</b>	<b>1,822</b>	<b>(115)</b>	<b>1,728</b>	<b>1,547</b>

# RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS 2012

## Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare

3

### Shënimi shpjegues 1. Ndarjet e fondit të përgjithshëm

Klasifikimi ekonomik	Shënime	2012	2011	2010
		BK € '000	BK € '000	BK € '000
Pagat dhe mëditjet		1,174	1,037	808
Mallrat dhe Shërbimet		554	574	707
Shërbimet Publike		32	35	32
Subvencionet dhe transferet		-	60	
Shpenzimet kapitale		55	22	
<b>Totali</b>		<b>1,815</b>	<b>1,728</b>	<b>1,547</b>

### Shënimi shpjegues 2. Grantet e përcaktuara të donatorëve

Klasifikimi ekonomik	Shënime	2012	2011	2010
		BK € '000	BK € '000	BK € '000
Mallrat dhe Shërbimet		7		
<b>Totali</b>	2.1	<b>7</b>	<b>-</b>	<b>-</b>

2.1 Shuma €7,315 paraqet donacionin nga Zyra Kombëtare e Auditimit të Suedisë për ZAP-in për të bashkëfinancuar konferencën vjetore të mbajtur më 10 dhe 11 Korrik në Pejë. Pjesëmarrës në këtë konferencë ishin stafi i ZAP-së, delegacione nga ZKA e Suedisë dhe Anglisë, një delegacion nga Kontrolli i Lartë i Shtetit të Shqipërisë, si dhe palët vendore të interesit. Kontributet e ngjashme të vitit të mëparshëm u paguan drejtpërdrejt në vendin e organizimit dhe jo ZAP-it.

### Shënimi shpjegues 3. Pagat dhe mëditjet

4

Përshkrimi	Shënime	2012	2011	2010
		BK € '000	BK € '000	BK € '000
<b>Pagesat nga BK</b>				
Neto pagat		988	876	687
Tatimi mbi të hyrat personale		71	63	45
Pagesa e kontributit pensional nga punëdhënësi		56	49	38
Pagesa e kontributit pensional nga i punësuar		56	49	38
Pagesat për Sindikata		3	0	0
<b>Totali</b>	3.1	<b>1,174</b>	<b>1,037</b>	<b>808</b>

#### Shënime

3.1 Nga kjo shumë e përgjithshme, 56% paraqet pagën bazë, 24% shtesat (p.sh. udhëheqësit e ekipeve), 4% shtesa të parapara me Ligjin për shërbimin civil dhe 16% për tatimet dhe kontributet. Pagesat për pagat neto pasqyrojnë reduktimin për përdorimin e telefonit personal mbi kontratën e zyrës me Z-mobile. Ato gjithashtu nuk përfshijnë kostot e AP-së dhe Shefit të Kabinetit të financiar nga Grupi Menaxhues Ndërkombëtar - shiko nenin 19.



# ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Shënimi shpjegues 4. Mallrat dhe shërbimet

Përshkrimi	Shënime	2012	2011	2010
		BK	BK	BK
Pagesat nga BK		€ '000	€ '000	€ '000
Shpenzimet e udhëtimit brenda vendit	4.1	30	24	9
Shpenzimet e udhëtimit jashtë vendit	4.2	21	12	17
Internet		3	3	2
Shpenzimet tjera telefonike /z.mobile	4.3	20	16	23
Shpenzimet postare		1	0	0
Shërbimet e arsimit dhe trajnimit	4.4	36	32	25
Shërb e ndr.intelektuale këshilldhënëse	4.5	77	102	235
Shërb kontraktuale tjera	4.6	8	18	11
Shërbime teknike		2	1	6
Shpenzimet për anëtarësim		1	2	
Mobiljet dhe pajisjet(më pak se 1000)		10	9	17
Telefona (më pak se 1000€)	4.7	3	10	10
Kompjuterë (më pak se 1000€)		26	27	30
Hardwer për TI<1000	4.8	5	1	1
Pajisje tjera <1000€	4.9	15	5	20
Furnizime për zyrë	4.10.	12	20	22
Furnizime ushqim dhe pije	4.11	17	4	1
Furnizime pastrimi		3	5	2
Furnizime veshmbathje			1	0
Akomodimi	4.11	5		6
Vaj për ngrohje	4.12	6	16	11
Derivate për gjenerator		1	2	1
Karburant për vetura		8	7	8
Regjistrimi i automjeteve		0	1	0
Sigurimi i automjeteve		5	6	6
Taksa komunale		0	0	1
Sigurimi i ndërtesave dhe tjera		12	13	15
Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve		6	4	4
Mirëmbajtja e ndërtesave		15	14	14
Mirëmbajtja e tekn.informative	4.13	12	6	15
Mirëmb.e mobileve dhe pajisjeve		2	1	0
Qiraja për ndërtesa		168	168	168
Qiraja-përdorime tjera ( TTK dhe SRK)	4.14	16	15	0
Reklamat dhe konkurset		3	3	2
Shërbime shtypje -jo marketing		10	10	1
Botimet e publikimeve				8
Informimi publik	4.15	1	9	9
Drekat zyrtare	4.11	1	7	4
<b>Totali</b>		<b>561</b>	<b>574</b>	<b>707</b>

## Shënime:

- 4.1 Shuma e shpenzuar për udhëtime zyrtare brenda Kosovës për auditim të komunave si dhe ndërrmarjeve Publiko -Private reflekton rritjen e numrit të auditimeve të kryera nga ZAP.
- 4.2 Këto shpenzime paraqesin shumën e shpenzuar për udhëtime zyrtare me qëllime trajnimit, pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare të auditimit, auditim i ambasadës së Kosovës në Londër si dhe pjesëmarrjes së një delegacioni të ZAP-së në seminarin e organizuar në Suedi me qëllim të ngritjes së bashkëpunimit bilateral në mes të ZAP-ZKSA
- 4.3 Kontrakta aktuale me Z-mobile e lidhur në 2011 ka gjeneruar kurseme vetëm pjesërisht pasuar nga një rritje në numrin e stafit.
- Stafi i cili i tejkalon limitet e përcaktuara me Politikën e brendshme të ZAP-së për shpenzime të telefonisë mobile, është i obliguar ti rimbursojë ato tejkalime përmes listës së pagave. Në bazë të kësaj politike, shumën e rimbursuar për vitin 2012 është €5,000. Në fakt shpenzimi nga BK nga ky kod është €15,000.
- 4.4 Ka pasur një investim në rritje sa i përket trajnimit brenda ZAP-it përmes SHKÇAK, UBT "QualityManagement Systems", dhe AUK programi "Trajnimi për Trajner".
- 4.5 ZAP ka reduktuar në mënyrë graduale numrin e komunave të kontraktuara jashtë - megjithatë rënia mes 2011-2012 gjithashtu reflekton dhe faktin se tenderi për auditimin e ndërmjetëm të pasqyrave financiare të Komunave për vitin 2012 ishte anuluar pas përgjigjes së dhënë nga OSHIP për rivlerësim të ofertave.
- 4.6 Ne angazhuam katër përkthyes me Kontratë mbi Vepër, në vend të kontraktimit të kompanive të jashtme për përkthimin e raporteve të auditimit në kulmin e sezonit. Kjo ka reflektuar me një kursim domethënës në buxhetin e ZAP-së krahasuar me vitin 2011.
- 4.7 Në vitin 2011, pjesa dërmuese e stafit të ZAP-së u pajis me aparate të telefonisë mobile. Këtë vit kemi blerë telefona mobil vetëm për stafin e ri të rekrutuar në vitin 2012.
- 4.8.Furnizim me swicha dhe UPS për nevoja të departamentit të Teknologjisë Informative për shkak të ngritjes së stafit auditues.
- 4.9. Kjo shumë prezanton shpenzimet për instalimin e sistemit të ri të vëzhgimit me kamera të teknologjisë më të re si dhe reflektorë për ndriçimin e objektit të ZAP-it, vendosjen e perdeve nëpër disa nga zyrat e objektit si dhe pajisje të ndryshme të vogla që nuk mund të përfshihen në kategori të caktuara.
- 4.10. Aktivitetet e prokurimit për furnizim me material zyrtar, në bazë të Udhëzimit Administrativ të KRPP-së tani do të kryhen nga AQP-ja, dhe si rezultat i kësaj ZAP nuk ka udhëhequr me procedura të prokurimit për furnizim me material zyrtar për nevoja të stafit të saj, dhe kjo ka rezultuar me shpenzime më të vogla në këtë kod.
- 4.11 Shpenzimet fillimisht të ndërlidhura me konferencën vjetore të ZAP-it janë pranuar përmes tre kodeve kontabël në vitin 2011, dhe në vitin 2012 vetëm në dy kode të tilla pas këshillës së dhënë nga Auditori jonë i Brendshëm. Totali e krabasueshme prej 23,000€ në 2012 dhe 11,000€ në 2011 pasqyrojnë faktin se në vitin 2011 financimi i jashtëm nga ZKA e suedisë u pagua drejtpërdrejt në vendin e organizimit të saj, dhe në vitin 2011 vendi i organizimit ishte Prishtina duke hequr nevojën për kalimin e natës (fjetjen). Këto diferencë shkuan në 12,000€ dhe si rrjedhojë nuk u rritën kostot mes viteve.

# RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS 2012

4.12 Për gjysmën e parë të vitit 2012, për ngrohje është përdorur nafta me të cilën jemi furnizuar në Dhjetor 2011.

4.13 Kjo ngritje e shpenzimeve është si rezultat i pagesës për mirëmbajtje edhe të 10 licencave të reja të softverit IDEA (softver për analizim të të dhënave)

4.14 Kjo shifër paraqet pagesat për fotokopjet e marra me qira si dhe për sistemet të regjistrimit të kohës.

4.15 Në bazë të Ligjit të ri për prokurimin publik, autoritetet kontraktuese nuk janë të obliguara ti publikojnë shpalljet për aktivitetet e prokurimit në gazetata ditore. Kjo ka rezultuar në mos shpenzimin e buxhetit në këtë kod ekonomik.

## Shënimi shpjegues 5: Shërbimet komunale

7

Përshkrimi	Shënim	2012	2011	2010
		BK € '000	BK € '000	BK € '000
Rryma		19	16	13
Uji		1	2	1
Mbeturinat		1	1	2
PTK-fikse	5.1	11	16	16
<b>Totali</b>		<b>32</b>	<b>35</b>	<b>32</b>

### Shënim:

5.1 Shfrytëzimi i shërbimeve të telefonisë mobile (Shënim 4.3) ka rezultuar me ulje të konsiderueshme të shpenzimeve në telefoninë fikse edhe përkunder shtimit të stafit.

## Shënimi shpjegues 6: Investime kapitale

Përshkrimi	shënim	2012	2011	2010
		BK € '000	BK € '000	BK € '000
Blerja e serverëve	6.1	55	22	
<b>Totali</b>		<b>55</b>	<b>22</b>	<b>-</b>

### Shënim:

6.1 Një infrastrukturë e re hardverike, që kërkon serverë të rinj ka rezultuar në rritjen e shpejtësisë së lidhjes së paisjeve të TIK-ut, krijimit të hapësirës më të madhe për fajllim elektronik të dokumenteve dhe zgjerimit të dhomës së serverëve.

## Shënimi shpjegues 7: Paga dhe Mëditje

8

Me rishikimin e buxhetit për vitin 2012, për ZAP-in u aprovuan 6 pozita për staf të ri. Shpenzimet për Pagat dhe Mëditje për këtë staf janë siguruar përmes transferit të mjeteve prej €16,500 nga kategoria ekonomike Transfere dhe Subvencione në kategorinë Paga dhe Mëditje.

## Shënimi shpjegues 8: Mallra dhe Shërbime

Ndryshimet që kanë ndodhur në këtë kategori ekonomike në vitin 2012 janë:

- Për blerjen e serverëve të rinj, shumata prej €10,000 është transferuar nga kategoria e Mallrave dhe Shërbimeve në kategorinë Shpenzimet Kapitale;
- Shumata prej €3,500 për nevojat e stafit të ri të rekrutuar u transferua nga kategoria Transfere dhe Subvencione në kategorinë Mallra dhe Shërbime; dhe
- Shumata prej €7,315 paraqet një donacion që Zyra Kombëtare Suedeze e Auditimit për bashkëfinancim të konferencës vjetore të organizuar nga ZAP ka transferuar në kategorinë mallra dhe shërbime. Si e tillë, lëvizja e buxhetit neto ishte zero.

## Shënimi shpjegues 9: Subvencione dhe transfere

Në vitin 2011, bazuar në vendimin Nr. 09/26, Qeveria e Kosovës, për të financuar funksionin e Auditorit të Përgjithshëm në buxhetin e ZAP-së, ka alokuar shumën €60,000 në kategorinë Subvencione dhe Transfere. Kjo shumë me datë 17.11.2011 është transferuar si avans në një fond të administruar nga GMN-ja (shih Nenin 19). Kjo do të shpenzohet për një periudhë dy vjeçare Tetor 2011 - Shtator 2013.

Në të njëjtën kategori ekonomike, me Ligjin e buxhetit për vitin 2012, ZAP-së i është ndarë shumata prej €100,000. Me rishikim të Ligjit të buxhetit për vitin 2012, ZAP-së i aprovohet kërkesa për rritje të stafit të saj për 6 pozita të reja. Për mbulimin e nevojës për këto pozita, nga kjo kategori ekonomike shumata €16,500 u transferua në kategorinë paga dhe mëditje dhe shumata €3,500 në kategorinë për mallra dhe shërbime.

Me vendim të Qeverisë së Kosovës, Nr.04/101 të datës 14.11.2012, buxheti i ZAP-it për Subvencione dhe Transfere u zvogëlua në zero.

## Shënimi 10. Shpenzimet Kapitale

Sipas Ligjit të Buxhetit 2012, ZAP-it iu alokua shumata prej €50,000 për blerjen e serverëve të rinj. Procesi i prokurimit ka identifikuar nevojën edhe për €10,000 në këtë kategori. Pas kërkesës së ZAP-it, Ministria e Financave transferoi këtë shumë nga kategoria Mallra dhe Shërbime në kategorinë Shpenzimet Kapitale, siç u theksua më lart.

# ZYRA E AUDITORIT TË PËRGGJITHSHËM

## Shpalosja e detyrimeve ( Neni 15 )

Detyrimet kontingjente

9

Natyra e detyrimeve kontingjente	Shënim	2,012	2011	2010
		€ '000	€ '000	€ '000
Qiraja		10	10	10
<b>Totali</b>	<b>15.1</b>	<b>10</b>	<b>10</b>	<b>10</b>

Shënim:

15.1 Shuma e prezantuar është një llogaritje e kompensimit eventual për riparime të ish-objektit tonë. Qiradhënësi i mëhershëm – me sa jemi në dijeni në vitin 2010, atëherë kur ne kemi kaluar në objektin tjetër - ka paraqitur rastin në gjykatë.

58211 49

## Shpalosja e pasurive ( Neni 16 )

16.a) Përmbledhje e pasurive jo-financiare (me vlerë mbi 1000€) në posedim të organizatës buxhetore

Klasifikimi i pasurive

	Shënim	2,012	Vlera neto në 2011	vlera neto në 2010
		€ '000	€ '000	€ '000
Veturat		23	45	68
Pajisje te TI	16.1	83	34	13
Pajisje tjera		9	11	25
<b>Totali</b>	<b>16a.1</b>	<b>115</b>	<b>90</b>	<b>106</b>

Shënim:

16.1 Në vitin 2012, ZAP ka blerë serverë dhe UPS në vlerë prej 55,526€. Kjo shumë është regjistruar në Free-Balance. Këtë vit norma e zhvlerësimit të licencave IDEA është korrektuar nga 33,33% për vit në 14,28% për vit. Këto licenca janë blerë dhe regjistruar nga ZAP në Free-Balance në vitin 2007. Kjo ka shkaktuar rritjen e vlerës së pasurisë në Free-Balance në shumën prej 5,680€. Vlera e zhvlerësimit është 37,467€

16.b) Përmbledhje e pasurive jo-financiare (me vlerë nën 1000€) në posedim të organizatës buxhetore

	Shënim	Vlera neto në 2012	Vlera historike në 2011	Vlera historike në 2010
		€ '000	€ '000	€ '000
Pasuria nën 1000€	16.2	115	343	319
<b>Totali</b>	<b>16b.1</b>	<b>115</b>	<b>343</b>	<b>319</b>

Shënim:

Në vitin 2012, pasuria e ZAP nën 1000€ është zhvlerësuar përmes softuerit 'Inventari' të cilin e përdorim paralelisht me softuerin E-pasuria e lancuar në vitin 2010 nga MAP. Por, gjenerimi i të dhënave nga softueri E-pasuria në lidhje me zhvlerësimin e këtyre pasurive ka rezultuar me informata të pasakta, prandaj ZAP ka përdorur të dhënat e gjeneruara nga softueri 'Inventari'.

16.c) Përmbledhje e stokeve në fund të periudhës

Klasifikimi i pasurive	Shënim	Vlera historike 2012	Vlera historike 2011	2010
		€ '000	€ '000	€ '000
Material zyrtar		13	7	
Derivate për ngrohjen qendrore dhe gjenerator		5	9	
<b>Totali</b>		<b>18</b>	<b>16</b>	

## Shpalosja e ndarjeve fillestare dhe finale të buxhetit ( Neni 18 )

10

Kategoria e ndarjes	Shënim	Përshtatjet e Autorizuara nga LMFPF						Ndryshimet e buxhetit fillestar
		Ndarja Fillestare Buxhetore (ligji i buxhetit)	Ndryshimi sipas nenit 30,Ligji nr.03/L-048	Ndryshimi sipas nenit 29,Ligji nr.03/L-048	Ndryshimi për të hyrat vetanake	Ndryshimet për grantet e përcaktuara te donatorëve	Ndarjet finale te buxhetit SIMFK	
		€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000	
<b>Hyrjet</b>		<b>a</b>	<b>b</b>	<b>c</b>	<b>e</b>	<b>f</b>	<b>(f-a)/f</b>	
Granti qeveritar		2,010	1,930	-		1,937	-3.8%	
Të hyrat vetanake	18.1				4		0.0%	
Grantet e përcaktuara të donatorëve	18.2					7		
		<b>2,010</b>	<b>1,930</b>	<b>-</b>		<b>7</b>	<b>-3.6%</b>	
<b>Daljet(buxheti)</b>								
Pagat dhe mëdritjet		1,198	1,215			1,215	1.4%	
Mallrat dhe shërbimet	18.3	622	615			622	0.1%	
Shërbimet publike		40	40			40	0.0%	
Transferet dhe subvencionet	18.4	100	0			-		
Shpenzimet Kapitale		50	60			60	16.7%	
Tjera							0.0%	
<b>Totali</b>		<b>2,010</b>	<b>1,930</b>	<b>0</b>		<b>7</b>	<b>-3.6%</b>	

Shënim:

18.1 Të hyrat vetanake tregojnë tarifën për auditimin e projektit "Rikonstruktimi i sheshit Skënderbeu në Pejë" (€ 870), të menaxhuar nga komuna e Pejës si dhe për auditimin e projektit në Ministrinë e Arsimit (€3,160) të menaxhuar nga DANIDA.

Këto mjete janë arketuar vetëm në llogarinë kryesore të Thesarit, pasi nuk janë të përfshira në buxhetin e ZAP-it.

18.2 Shih shënimin shpjegues 2

18.3 Shih shënimin shpjegues nr. 8

18.4 Shih shënimin shpjegues nr.9



# RAPORTI VJETOR I PERFORMANCËS 2012

## Numri i punëtorëve ( Neni 19 )

11

Departamenti	Nr i punëtorëve ne Ligjin e buxhetit 04/L-079	Nr. Aktual i punëtorëve në fillim të vitit 2012	Nr. Aktual i punëtorëve në fund të vitit 2012
<b>TOTALI</b>			
Stafi (Auditorë & Mbështetës)	130	131*	142**

### Shënim

\* Numri i punëtorëve prej 131 në fillim të vitit 2012 është më i lartë se kufiri i caktuar për shkak të zëvendësuesve të punësuar për të mbuluar stafin jo aktiv që janë në pushim të lindjes.

\*\* Me rishikim të buxhetit të ZAP, janë miratuar edhe 6 pozita shtesë, duke e rritur kufirin e punëtorëve nga 130 në 136. Në fund të vitit 2012, numri i punëtorëve ka arritur në 142, kështu duke numëruar 134 punëtorë të rregullt dhe 8 punëtorë zëvendësues për të mbuluar stafin që janë në pushim të lindjes. Ndërkohë ne kemi punësuar zëvendësues për të mbuluar stafin e sipërpërmendur dhe numri total i zëvendësuesve deri në fund të vitit 2012 është 8 zëvendësues.

Auditori i Përgjithshëm dhe Shefi i Kabinetit të tij nuk llogariten në kufirin e stafit për shkak se pagat e tyre paguhen nga Zyra e Përfaqësuesit Ndërkombëtar (ZNP). Pas përfundimit të misionit të ZNP-së në Kosovë në shtator të vitit 2012, pagat e Auditorit të Përgjithshëm dhe Shefit të Kabinetit të tij menaxhohen nga Grupi Menaxhues Ndërkombëtar, i cili është themeluar si një organ profesional për të ndihmuar institucionet Kosovare që të mbulojnë grantet dhe transaksionet ndërkombëtare nga organizata donatore të ndryshme dhe agjenci shtetërore për ekspertët ndërkombëtarë.

## Raporti për veprimet e ndërmarra dhe të propozuara për gjetjet dhe rekomandimet e Auditorit të pavarur ( Neni 20 )

PVF-të të ZAP për vitin 2011 janë audituar nga Deloitte (emëruar nga Kuvendi). Është dhënë opinionin i pakualifikuar. Në letërën e menaxhmentit janë dhënë rekomandime në lidhje me disa mangësi të MFK-së:

Nr.	Rekomandimet	Veprimi i ndërmarrë ose i propozuar	Afati i Zbatimit	Efekti
1	Barazimi mes pasqyrave dhe shënimeve	Ideja e auditorëve ishte që barazimi duhet të bëhet		Meqenëse kjo ndërlihet vetëm me rumbullaksimet në llogari, nuk ka çështje materiale për të adresuar
2	Barazimi me Thesarin	Kjo ka të bëjë me llogarinë e ZAP-it dhe diferencat mes PVF-ve dhe shifrave në llogari deri në datën 31.12.2011		Ne do ta diskutojmë këtë çështje me Thesarin me qëllim që të arrijmë një qasje të përgjithshme për të gjithë shpenzuesit buxhetor.
3	Kompletimi i deklaratsë së nevojave dhe disponueshmërisë së mjeteve	Trajtim më me kujdes i kësaj deklarate në proceset në vazhdim	E kryer	Trajtim më i mirë administrativ
4	Përbajtja e afateve kohore për publikim të njoftimeve për dhënie të kontratës	Përkushtim më i madh në aspekt të përbushjes së afateve ashtu siç e parasheh LPP	E kryer	Trajtim më i mirë administrativ
5	Përbajtja e afateve kohore për praninë të dosjeve të tenderit	Përkushtim më i madh në aspekt të përbushjes së afateve ashtu siç e parasheh LPP	E kryer	Trajtim më i mirë administrativ
6	Zotim i mjeteve financiare para se të nënshkruhet kontrata me OE	Shtimi i kujdesit që kjo pakujdesi të mos përsëritet në të ardhmen	E kryer	Trajtim më i mirë administrativ
7	Dosjet e pakompletuara të personelit	Procesi i kompletimit të dosjeve personale të stafit të ZAP-së me akte emërimi në këtë fazë është finalizuar në tërësi. Për momentin jemi në proces të implementimit të një baze të të dhënave për personel, e cila do të ofrojë lehtësira të shumta në këtë drejtim.	E kryer	Trajtim më i mirë administrativ
8	Zhvlerësimi i pasurisë me vlerë më të vogël se € 1,000	Modeli i zhvlerësimit në Sistemin E-Pasuria ende nuk po funksionon. Pavarësisht problemeve në sistemin qendror, ne do të bëjmë zhvlerësimin e brendshëm të të gjitha pasurive të ZAP-it para fundit të vitit 2012,	Fundi i vitit 2012	Trajtim më i mirë administrativ



## SHTOJCA 3: Opinioni i Auditorit të Jashtëm



Tel: +381 38 221 170  
Fax: +381 38 221 172  
www.bdokosovo.com

BDO Kosova L.L.C.  
Rr. Luan Haradinaj H5, Nr. 7  
10000 Prishtina Kosova

### Raporti i Auditorit të Pavarur

#### Për menaxhmentin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm

Ne kemi qenë të angazhuar për auditimin e pasqyrave financiare shoqëruese të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm (më tej referuar si “Organizata” ose “ZAP”), që përfshinë Pasqyrën Pranimit të Ardhurave dhe Pagesave dhe Raportin e Ekzekutimit të Buxhetit më dhe për fund vitin 31 Dhjetor 2012, si dhe një përmbledhje të politikave të kontabilitetit dhe shënimeve tjera shpjeguese. Pasqyrat financiare për fund vitin 31 Dhjetor 2011 janë audituar nga auditor tjetër i cili ka shpreh opinion të pakualifikuar me 9 Gusht 2012.

#### *Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pasqyrat*

Menaxhmenti është përgjegjës për përpilimin dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave në përputhje me udhëzimet e përcaktuara në Ligjin Numër 03/L-048 mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Ligjin Numër 03/L-221 për Amandamentimin dhe Plotësimin, i cili përcakton që pasqyrat financiare duhet të përgatiten sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (“IPSAS”), “Raportimi Financiar sipas Bazës së Kontabilitetit me Para të Gatshme”. Kjo përgjegjësi përfshin: dizajnimin, zbatimin dhe mirëmbajtjen e kontroleve të brendshme që lidhen me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të Pasqyrave të cilat nuk përmbajnë deklarata materialisht të gabuara, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit; duke zgjedhur dhe zbatuar politika përkatëse të kontabilitetit; dhe duke bërë vlerësime kontabël që janë të arsyeshme në rrethanat përkatëse.

#### *Përgjegjësia e Auditorit*

Përgjegjësia jonë është të shprehim opinion për Pasqyrat bazuar në auditimin tonë. Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të jemi në pajtueshmëri me kërkesat etike si dhe të planifikojmë dhe kryejmë auditimin për të arritur siguri të arsyeshme që Pasqyrat nuk përmbajnë deklarata materialisht të gabuara.

Auditimi përfshinë përmbushjen e procedurave për të marrë dëshmi të auditimit për shumat dhe shpalosjet në Pasqyrat. Procedurat e përzgjedhura varen nga vlerësimet e auditorit, përfshirë vlerësimet e rrezikut të deklaratave materialisht të gabuara qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në arritjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, auditori merr parasysh kontrollin e brendshëm që ka të bëjë me përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave të entitetit në mënyrë që të përcaktoj procedurat e auditimit që janë të përshtatshme në rrethana, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit në efikasitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi gjithashtu përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave të përdorura kontabël dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të përgjithshëm të Pasqyrave.

Ne besojmë se të dhënat e auditimit që ne i kemi përdorur janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë bazat për opinionin tonë të auditimit.



## *Opinion*

Sipas opinionit tonë, Pasqyrën e Pranimit të Ardhurave dhe Pagesave dhe Raportin i Ekzekutimit të Buxhetit më dhe për fund vitin 31 Dhjetor 2012 paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale dhe performansën e Zyrës së Auditorit Gjeneral në përputhje me Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik ("IPSAS"), "Raportimi Financiar sipas Bazës së Kontabilitetit me Para të Gatshme" si dhe pajtueshmërinë me ligjet dhe rregulloret.

Ky raport është përkthim i versionit origjinal në Anglisht, në rast mospërputhjeje midis këtyre dy raporteve, raporti në gjuhën Angleze do të mbizotërojë.

BDO Kosova L.L.C.

BDO Kosova L.L.C  
Prishtinë, Kosova  
16 Prill 2013

Për informata të mëtutjeshme, ju lutem kontaktoni:  
Za vise informacija, molimo vas kontaktirajte:  
For further information, please contact:

Ilire Daija - Buza  
ilire.daija@oagks.org  
+381 (0) 38 25 35 121

Qëndresa Mulaj  
qendresa.mulaj@oagks.org  
+381 (0) 38 25 35 262

#### **ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM**

Adresa: Rr. "Musine Kokollari", nr 16  
10000 Prishtinë, Kosovë

Telefon: +381 (0) 38 25 35 217  
Faks: +381 (0) 38 25 35 122  
<http://oag.rks-gov.net>